




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

**Parandalimi dhe reagimi
ndaj situatave emergjente:
Vërshimet**



Prishtinë, Korrik 2021

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare. Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA 3000¹) si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditimet e performancës të ndërmarra nga Zyra Kombëtare e Auditimit janë shqyrtime objektive dhe të besueshme që vlerësojnë nëse veprimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat veprojnë në përputhje me parimet e ekonomisë², efikasitetit³ dhe efektivitetit⁴ dhe nëse ka vend për përmirësim.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me përmbajtjen e raportit të auditimit “Parandalimi dhe reagimi i situatave emergjente: Vërshimet” në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm, Vlorë Spanca, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Ekipi që realizoi këtë raport:

Myrvete Gashi, *Udhëheqës i Auditimit*

Ariana Gjonbalaj Shala, *Udhëheqës i ekipit*

Shkurta Stublla, *Anëtare e ekipit*

Ylfete Osmani, *Anëtare e ekipit*

1 Standardet dhe udhëzimet për auditimin e performancës bazuar në Standardet e Auditimit të ONISA-s dhe përvoja praktike

2 Ekonomia - Parimi i ekonomisë nënkupton minimizimin e kostos së burimeve. Burimet e përdorura duhet të jenë në dispozicion në kohën e duhur, në sasinë dhe cilësinë e duhur dhe në çmimin më të mirë të mundshëm.

3 Efikasiteti - Parimi i efikasitetit nënkupton marrjen e maksimumit nga burimet në dispozicion. Ka të bëjë me lidhjen mes burimeve të përfshira dhe rezultatit të dhënë në aspektin e sasisë, cilësisë dhe kohës.

4 Efektiviteti - Parimi i efektivitetit nënkupton arritjen e objektivave të paracaktuara dhe arritjen e rezultateve të pritshme.

Tabela e përmbajtjes

Përmbledhje e përgjithshme	1
1.Hyrje	3
1.1. Treguesit e problemit në fushën e audituar.....	5
2.Objektiva dhe pyetjet e auditimit	10
3.Gjetjet e auditimit.....	11
3.1. Dokumentet strategjike për parandalimin dhe reagimin ndaj situatave emergjente.....	11
3.2. Vlerësimi i rrezikut në nivel vendi dhe të dhënat historike mbi fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera	15
3.3. Monitorimi i aktiviteteve të parandalimit dhe reagimit nga fatkeqësitë natyrore dhe matja e performancës së Njësive Zjarrfikëse	17
3.4. Burimet njerëzore dhe teknike për reagim ndaj situatave emergjente	23
4.Konkluzionet	31
5.Rekomandimet	33
Shtojca 1. Kriteret, fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia.....	35
Shtojca 2. Përshkrimi i sistemit dhe akterëve relevant	41
Shtojca 3: Letër Konfirmimet	45

Lista e shkurtesave

AME	Agjencioni i Menaxhimit Emergjent
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
QS	Qendra e Situatave
KSK	Këshilli i Sigurisë së Kosovës
FSK	Forca e Sigurisë së Kosovës
NJPZSh	Njësia Profesionale për Zjarrëfikje dhe Shpëtim
PRK	Plani i Reagimit Kombëtar
PK	Policia e Kosovës
DMSH	Drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim

Përmbledhje e përgjithshme

Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer auditimin e performancës “Parandalimi dhe reagimi ndaj situatave emergjente: Vërshimet”. Palët përgjegjëse për menaxhimin e situatave emergjente në nivel qendror, të cilat edhe kanë qenë subjekt i auditimit janë: Agjencia për Menaxhim Emergjent në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Qendra e Situatave në kuadër të Këshillit të Sigurisë së Kosovës si dhe Forca e Sigurisë së Kosovës. Përderisa në nivel lokal, subjekt i auditimit janë komunat Gjakovë dhe Vushtrri përkatësisht drejtoritë përkatëse komunale si dhe Njësitë Profesionale për Zjarrfikje dhe Shpëtim. Përzgjedhja e komunave Gjakovë dhe Vushtrri është bërë duke marrë parasysh shpeshtësinë e fatkeqësive të ndodhura në këto komuna për periudhën e fushëveprimit 2019, 2020 deri në janar të vitit 2021.

Konkluzioni i auditimit është se institucionet përgjegjëse në nivelin qendror dhe atë lokal, nuk kanë arritur të krijojnë një sistem të përshtatshëm i cili siguron në mënyrë efektive parandalimin dhe reagimin ndaj situatave emergjente të vërshimeve/përmbajtjeve në Republikën e Kosovës.

Aktivitetet e ndërmarra për parandalimin dhe reagimin ndaj situatave emergjente të vërshimeve janë përcjellë me disa mangësi të cilat e kanë vështirësuar menaxhimin e këtyre situatave. Mangësitë e identifikuar në aktivitetet e parandalimit dhe reagimit ndaj situatave emergjente gjatë vërshimeve janë:

- 1. Këshilli i Sigurisë së Kosovës dhe Ministria e Punëve të Brendshme nuk kanë arritur të përditësojnë dokumentet strategjike për reagim dhe menaxhim të situatave emergjente.*** Këto dokumente nuk janë përditësuar që nga viti 2010 dhe të njëjtat vazhdojnë të përdoren edhe sot. Strategjia e Sigurisë së Kosovës deri në miratimin e dokumentit të ri mbetet me dokumentin e vitit 2010 i cili mund të mos pasqyrojë rrethanat e reja në fushën e menaxhimit të emergjencave. Plani i Reagimit Kombëtar nuk ka gjetur zbatueshmëri në shumë intervenime që janë bërë gjatë ndodhjes së fatkeqësive.
- 2. AME-ja nuk ka arritur që të rivlerësojë dhe përditësojë dokumentet për vlerësimin e rreziqeve dhe të dhënat historike mbi fatkeqësitë në nivel vendi.*** Përditësimi i dokumentit për vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në nivel vendi nuk është bërë që nga viti 2016. Mospërditësimi i këtij dokumenti ka pamundësuar parashikimin e fatkeqësive dhe pasojave të mundshme nga fatkeqësitë, duke pamundësuar të bëhet vlerësimi i duhur i mbrojtjes nga rreziqet përkatëse dhe masat parandaluese për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë. Të dhënat historike mbi fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera nuk janë të plota. Databaza DesInventar me të dhëna historike, analizon trendet e katastrofës dhe ndikimet e tyre në mënyrë sistematike. Databaza e cila është në funksion dhe është e çashtme vetëm brenda rrjetit qeveritar, nuk është plotësuar nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent dhe komunat, e cila së fundmi është përditësuar në vitin 2019. Për vitin 2020 nuk ka të dhëna në sistem.
- 3. AME-a nuk ka arritur të monitorojë aktivitetet e parandalimit dhe matjes së performancës të Njësisve Profesionale për Zjarrfikje dhe Shpëtim.*** AME-ja nuk është e informuar dhe nuk ka bërë verifikimin e gjendjes në komuna mbi posedimin e dokumentit të rrezikut dhe planit për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë, si pasojë e mosplotësimit të pozitës së kryeinspektorit. Përderisa, niveli lokal nuk ka arritur të finalizojë dokumentet për vlerësimin e

rrezikut dhe planet për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë. Ka mungesë të raporteve pas veprimit në komunën e Vushtrrisë dhe Gjakovës. Gjithashtu nuk është bërë matje e performancës së Njësive Profesionale për Zjarrfikje dhe Shpëtim, e cila është e rëndësishme për të identifikuar problemet dhe shkaqet eventuale dhe për të planifikuar aktivitetet për të ardhmen.

- 4. Niveli qëndror dhe lokal nuk kanë arritur të sigurojnë burimet njerëzore dhe teknike të mjaftueshme për reagim ndaj situatave emergjente/vërshimet.** *Ka mungesë të burimeve njerëzore dhe teknike të ndihmës dhe shpëtimit. Nuk është e funksionalizuar Njësia për intervenime të specializuara për shpëtim nga ujërat e thella (zhytje). Aktualisht këto njësi janë pjesë e zjarrfikësve dhe e kanë si punë sekondare pjesën e shpëtimit në ujëra sipërfaqësore. Për momentin, Forca e Sigurisë së Kosovës është e vetmja që merret me pjesën e kërkim-shpëtimit në ujëra të thella. Poashtu, nuk është bërë verifikimi i aftësisë psiko-fizike të antarëve të Njësive Profesionale të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit. Në mungesë të kapaciteteve njerëzore dhe teknike është e pa mundur ngritja e gatishmërisë reaguese në nivel më të lartë dhe e vështirëson operimin dhe reagimin e shpejt dhe efikas në rast të fatkeqësive natyrore apo fatkeqësive tjera.*

Përfundimet audituese tregojnë se institucionet përgjegjëse nuk kanë arritur të krijojnë një sistem të përshtatshëm i cili siguron në mënyrë efektive parandalimin dhe reagimin ndaj situatave emergjente të vërshimeve/përmbytjeve në Republikën e Kosovës. Me qëllim të rregullimit të mënyrës së menaxhimit të emergjencave, janë dhënë 11 rekomandime për institucionet përgjegjëse. Lista e rekomandimeve është paraqitur në kapitullin 5 të këtij raporti.

Përgjigja e palëve të përfshira në auditim


Agjencia për Menaxhim Emergjent, Qendra e Situatave, Forca e Sigurisë së Kosovës, Komuna e Gjakovës dhe Komuna e Vushtrrisë janë pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe janë zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna. Ndërsa, nuk kemi pranuar përgjigje nga Ministria e Punëve të Brendshme. Inkurajojmë subjektet e përfshira në këtë auditim që ti bëjnë të gjitha përpjekjet për t'i adresuar rekomandimet e dhëna.

1. Hyrje

Gjatë shekullit njëzet e një, një numër ngjarjesh të ndjeshme kanë përqendruar vëmendjen në aftësinë e shoqërive në mbarë botën, për t'iu përgjigjur emergjencave siç janë katastrofat natyrore, aksidentet industriale dhe shpërthimi i epidemive të ndryshme, disa prej të cilave ndodhin natyrshëm e disa nga faktori njeri.

Planifikimi apo programet e kontrollit të situatave emergjente nuk mund të lihen deri në momentin e ndodhjes së fatkeqësisë. Në situatat emergjente të krijuara pa prituri, çdo vonesë në menaxhimin e situatës së shkaktuar do të rezultojë në përhapjen e mëtejshme të fatkeqësisë (në rastin e fundit me pandeminë COVID-19). Nga ana tjetër, pas përfundimit të emergjencës është e rëndësishme që të ndërmerren masa për rimëkëmbjen e komuniteteve të prekura. Këto probleme mund të shmangen nëse ekziston një planifikim dhe përgatitje e duhur për parandalimin dhe tejkalimin e këtyre situatave.

Menaxhimi i emergjencave kërkon një organizim të mirë institucional në aspektin e gatishmërisë për parandalimin apo reagimin ndaj situatave të jashtëzakonshme. Reagimi ndaj rasteve emergjente paraqet një varg aktiviteteve sfiduese që duhet të ndërmerren nga institucionet shtetërore. Situatat e jashtëzakonshme dallojnë nga përmasat, shkaqet dhe pasojat, kështu që kërkojnë një përgatitje dhe reagim institucional të organizuar mirë. Në *Figurën 1* kemi ilustruar ciklin e planifikimit të mirë dhe kontrollit për menaxhimin e situatave emergjente.

*Fig 1. Cikli i menaxhimit të emergjencave (vërshimeve)***MENAXHIMI I EMERGJENCAVE**

Cikli i menaxhimit të emergjencave tregon se gatishmëria e mirë për emergjencat është një proces i vazhdueshëm. Gjithashtu sqaron faktin se kur ndodh ndonjë fatkeqësi, reagimi i shpejtë është thelbësor për të minimizuar dëmet njerëzore dhe materiale. Bazuar në përvojat e më hershme pas çdo gjendje jo të zakonshme vjen periudha e rimëkëmbjes dhe e rikthimit të ekonomisë apo sektorëve të prekur, në gjendjen e mëparshme.

Planifikimi dhe praktikimi bëhet në të gjitha fazat e ciklit. Është sidomos e rëndësishme që planet e reagimit të testohen rregullisht dhe tërësisht si pjesë e fazës përgatitore. Kjo do të sigurojë që planet të jenë praktike, të realizueshme dhe se njerëzit që do të përballen me problemin në terren janë plotësisht të trajnuar në zbatimin e rolit të tyre.

Në aspektin e pozitës gjeografike Kosova ndodhet në një zonë sizmike aktive, duke e bërë atë më të ndjeshme ndaj tërmeteve. Kurse, në zonat malore ka vërshime të befasishme, të cilat në disa raste rezultojnë në rrëshqitje të dheut.⁵

Pas paraqitjes së rasteve të vërshimeve në një komunitet, ndërhyrja e menjëhershme e institucioneve kompetente mundëson minimizimin e dëmeve të shkaktuara nga këto fatkeqësi. Kjo ndërhyrje bëhet përmes aktiviteteve të reagimit emergjent⁶ të cilat adresojnë efektet e shpejta dhe të drejtpërdrejta të një incidenti, duke i përfshirë veprimet e menjëhershme për ruajtjen e jetës, të mirave materiale dhe mjedisit të komunitetit të goditur.

Aksionet e reagimit për shpëtim dhe ndihmë në komunitetet e goditura nga vërshimet mund të jepen nga tri nivele reaguesish varësisht prej nivelit të urgjencës së situatës së paraqitur. Niveli i parë janë niveli komunal nga Njësitë për Zjarrfikje dhe Shpëtim (NJPSH) dhe drejtoritë komunale, niveli i dytë janë regjionet tjera dhe Agjencia për Menaxhim të Emergjencave (AME) ndërsa niveli i tretë janë Qendra e Situatave (QS) dhe Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK). Përshkrimi më i detajuar i këtyre niveleve është në shtojcën 2.

1.1. Treguesit e problemit në fushën e audituar

Situatat emergjente gjatë viteve të fundit në Kosovë kanë qenë të natyrës së ndryshme nisur nga ato shëndetësore, ekonomike apo sociale.

Në aspektin e përgjithshëm mjedisor, gjeografik apo të faktorëve tjerë me ndikim, është konfirmuar dhe dokumentuar se Kosova ka një ekspozim dhe cënueshmëri të konsiderueshme ndaj fatkeqësive natyrore dhe teknologjike. Fatkeqësitë natyrore që godasin dhe rrezikojnë më së shpeshti Kosovën janë: vërshimet, thatësitë, zjarret pyjore, tërmetet dhe orteqet e borës.

Vërshimet janë ndër katastrofat natyrore më të shpeshta dhe më të kushtueshme. Ato shpesh ndodhin pas shkrirjes së borës ose disa ditëve të shiut të vazhdueshëm. Vërshimet e rrëmbyeshme ndodhin papritmas, për shkak të ngritjes së shpejtë të ujit përgjatë një përroi ose një zone të ulët.⁷

Shkatërrimi fizik që shkaktohet nga vërshimet varet nga shpejtësia dhe niveli i ujit, kohëzgjatja e përmbytjes, kushtet e terrenit dhe mjedisi i ndërtuar. Disa nga pasojat e vërshimeve janë:

- *Dëmet fatale dhe serioze tek njerëzit që mbesin të bllokuar gjatë përmbytjeve;*
- *Rrugët e transportit, energjia, uji, gazi dhe shërbimet tjera mund të ndërpriten;*

5 Raporti hulumtues i ZRRF-së për legjislacionin dhe përgjegjësitë e palëve të interesit në Kosovë – Save the Children Kosovë

6 Ligji 04/-L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera, Neni 3

7 Flood safety, ref: <https://www.redcross.org/get-help/how-to-prepare-for-emergencies/types-of-emergencies/flood.html>

- *Furnizimi me ujë të pijshëm mund të vështirësohet dhe puset mund të ndoten;*
- *Erozioni mund të dëmtojë rrugët, strukturat e urave, nivelet dhe ndërtesat me themele të dobëta, duke shkaktuar shembjen e tyre pa paralajmërim;*
- *Mund të ketë rrëshqitje dheu; dhe*
- *Përmbytja më e vogël në një shtëpi mund të shkaktojë dëme të mëdha financiare.⁸*

Vërshimet e fundit që ndodhën në rajonin e Vushtrrisë, Fushë Kosovës, Gjilanit, Gjakovës, Malishevës, Drenasit, Klinës, Ferizajit, Lipjanit dhe Prizrenit gjatë muajit janar 2021, tregojnë mangësitë e infrastrukturës dhe sistemit të emergjencave në Kosovë.⁹

Reagimi emergjent përfshinë aktivitetet të cilat adresojnë efektet e shpejta dhe të drejtpërdrejta të një incidenti, duke i përfshirë veprimet e menjëhershme për ruajtjen e jetës, të mirave materiale dhe mjedisit, plotësimin e nevojave elementare njerëzore si dhe mirëmbajtjen e strukturës sociale, ekonomike dhe politike të komunitetit të goditur.¹⁰ Në nivelin komunal, pas marrjes së informacionit nga publiku, njësitë policore paraqiten në vendin ku është paraqitur fatkeqësia me ç'rast ftohen ekipet e zjarrfikjes për të ndërhyrë.

Komuna e Vushtrrisë dhe ajo e Gjakovës, ishin ndër komunat me rastet e vërshimeve më të shpeshta gjatë muajit janar 2021 që kishin reagu edhe njësitë zjarrfikëse në këto dy komuna. Gjatë vitit 2019 në këto komuna, nuk ka reagime të evidentuara të zjarrfikësve për evitim të rasteve të vërshimeve dhe gjatë vitit 2020 janë 9 raste në Komunën e Vushtrrisë dhe 14 raste në Komunën e Gjakovës. Për muajin janar 2021, në Komunën e Vushtrrisë ka pasur 44 intervenime dhe në Komunën e Gjakovës 67 intervenime. Kjo është paraqitur edhe përmes grafikut më poshtë:

8 Disaster and Emergency preparedness for Flooding and Hurricanes, ref: http://wow.uscgauz.info/Uploads_wowII/054-20/5SR_Disaster_and_Emergency_FINAL_1.pdf


9 Vërshimet nxjerrin në pah dobësitë në infrastrukturë dhe sistem të emergjencës, ref: <https://kallxo.com/gjate/vershimet-nxjerrin-ne-pah-dobesite-ne-infrastruktura-dhe-sistem-te-emergjences/>

10 Ligji Nr. 04/-L-027 Për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera, Neni 3


Komunat: Komuna e Vushtrrisë dhe e Gjakovës

Grafiku 1: Intervenimet e NJPZSH në Vushtrri dhe Gjakovë ¹¹

**INTERVENIMET E ZJARRFIKSËVE
NË KOMUNËN E VUSHTRRISË**



**INTERVENIMET E ZJARRFIKSËVE
NË KOMUNËN E GJAKOVËS**



11 Shënime nga AME

Dëmet e krijuara nga vërshimet e fundit, janar 2021, kanë qenë në vlerë prej 518,053.00€ në Komunën e Vushtrrisë dhe 564,960.50€ në Komunën e Gjakovës.




Foto 1. Vërshimet e fundit në Vushtri, janar 2021¹²




Foto 2. Reshjet në Gjakovë¹³

¹² Përmbijtjet nga degradimi i lumenjeve, ref: <https://kallxo.com/lajm/permbytjet-nga-degradimi-i-lumenjve/>

¹³ <https://kallxo.com/lajm/foto-vershimet-ne-gjakove-qindra-hektare-te-permbytura-nga-uji/>




Foto 3. Reshjet në Gjakovë ¹⁴

Komunat përpos njësive të reaguesve të parë, kanë në dispozicion edhe kompani të kontraktuara të cilat asistojnë në aspektin teknik sa herë që kërkohet nga komuna. Gjatë muajit janar 2021, kishte raste kur komunat nuk arritën të menaxhojnë situatat e vërshimeve me kapacitetet e veta me ç'rast ato kishin kërkuar mbështetje nga niveli qendror.

Sipas hidrologëve nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës, vërshimet që ndodhën së fundmi në Kosovë duhet të jenë një alarm për autoritetet që të ndërmarrin masa për parandalimin e fatkeqësive të tilla duke përgatitur plane afatmesme dhe afatgjate për mirëmbajtjen e lumenjëve.¹⁵

Në strategjinë për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe Planin e veprimit 2016 – 2020 është theksuar se mungojnë kapacitetet teknike dhe organizative institucionale për menaxhimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe të tjera përfshirë sistemin e paralajmërimit të hershëm dhe gatishmërisë.¹⁶ Kjo vjen si pasojë e mungesës së koordinimit ndër-institucional¹⁷ dhe mungesës së evidencës për fatkeqësitë e ndodhura viteve të fundit.

Edhe pse janë ndërmarrë disa aktivitete institucionale lidhur me menaxhimin dhe reagimin ndaj fatkeqësive në Kosovë, ka indikacione se menaxhimi i fatkeqësive nuk është duke u kryer në mënyrë efektive. Andaj, indikatorët e cekur kanë shërbyer për të iniciuar auditimin e sistemit për parandalimin dhe reagimin në situata emergjente në vendin tonë.

¹⁴ <https://kallxo.com/lajm/foto-vershimet-ne-gjakove-qindra-hektare-te-permbytura-nga-uji/>

¹⁵ <https://kallxo.com/lajm/permytjet-nga-degradimi-i-lumenjve/>

¹⁶ Strategjia për zvogëlim të rrezikut nga fatkeqësitë dhe plani i veprimit 2016 – 2020

¹⁷ Strategjia për zvogëlim të rrezikut nga fatkeqësitë dhe plani i veprimit 2016 – 2020

2. Objektiva dhe pyetjet e auditimit

Objektivë e këtij auditimi është të vlerësohet nëse Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave dhe institucionet tjera relevante kanë arritur të krijojnë një sistem të përshtatshëm i cili siguron në mënyrë efektive parandalimin dhe reagimin ndaj situatave emergjente me fokus tek vërshimet/përmbytjet në Republikën e Kosovës.

Për t'iu përgjigjur objektivës së auditimit janë parashtruar pyetjet si në vijim:

Pyetja kryesore e auditimit:

A kanë ndërmarrë institucionet përgjegjëse të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar menaxhimin efektiv për parandalimin dhe reagimin ndaj situatave emergjente me fokus vërshimet?

Nën pyetjet e auditimit:

1. A kanë arritur institucionet përgjegjëse të ndërmarrin veprimet e duhura për parandalimin e fatkeqësive (vërshimeve)?
2. Cilat veprime janë ndërmarrë nga AME-ja dhe institucionet tjera për të menaxhuar në mënyrën e duhur rastet e vërshimeve që kanë ndodhur?
3. Sa janë të bashkërenduara aktivitetet e AME-së me institucionet tjera relevante për të siguruar menaxhimin efektiv të situatave emergjente?

Ky auditim ka përfshirë periudhën 2019, 2020 deri në janar 2021. Në fokus të auditimit kanë qenë aktivitetet e zhvilluara nga AME-ja në kuadër të MPB-së, Qendra e Situatave në kuadër të KSK-së, FSK-ja dhe komunat e përzgjedhura. Komunat Gjakovë dhe Vushtrri janë përzgjedhur duke marrë parasysh shpeshtësinë e fatkeqësive të ndodhura për periudhën e fushëveprimit të këtij auditimi.

Metodologjia e detajuar e auditimit e aplikuar gjatë këtij auditimi, kriteret e auditimit dhe fushëveprimi i auditimit janë paraqitur në *Shtojcën 1*, ndërsa përshkrimi detaj i sistemit dhe përgjegjësitë e palëve relevante janë të paraqitura në *shtojcën 2* të këtij raporti.

3. Gjetjet e auditimit

Në këtë kapitull janë prezantuar gjetjet e auditimit që kanë të bëjnë me sistemin e parandalimit dhe reagimit ndaj situatave emergjente.

Gjetjet janë rezultat i analizimit dhe vlerësimit të dokumentacionit, auditimit të proceseve, intervistave me zyrtarë përgjegjës, testimeve si dhe vëzhgimeve fizike në terren. Këto kanë shërbyer në dhënien e konkluzioneve të cilat janë paraqitur në Kapitullin 4 dhe rekomandimeve për përmirësimin e sistemit, të cilat janë paraqitur në Kapitullin 5.

3.1. Dokumentet strategjike për parandalimin dhe reagimin ndaj situatave emergjente

3.1.1. Strategjia e Sigurisë e Republikës së Kosovës nuk është përditësuar që nga viti 2010

Strategjia e sigurisë duhet rishikuar rregullisht dhe të përshtatet me rrethanat e ndryshueshme.¹⁸ Këshilli i Sigurisë së Kosovës në koordinim me Presidentin e Republikës së Kosovës, udhëheq procesin e rishikimit të Strategjisë Kombëtare të Sigurisë aktuale dhe harton një Strategji të re Kombëtare të Sigurisë për tu miratuar nga Qeveria dhe dorëzuar në Kuvend për miratimin përfundimtar. Rishikimi dhe prezantimi i Strategjisë së re Kombëtare të Sigurisë për miratim duhet të bëhet jo më larg se fundi i shtatorit 2014.¹⁹

Strategjia e Sigurisë për Republikën e Kosovës në nivel Kombëtar është dokument i hartuar në vitin 2010 nga Këshilli i Sigurisë i Kosovës. Ky dokument i parashtron objektivat strategjike të sigurisë së shtetit dhe prezenton ministrinë dhe agjensionet që angazhohen për t'i arritur ato. Veç kësaj, identifikon sfidat e sigurisë dhe diskuton mënyrat, përmes të cilave ministrinë, agjensitë dhe qytetarët mund ti adresojnë ato së bashku.²⁰

Në Analizën e Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë të vitit 2014, është rekomanduar të bëhet rishikimi dhe hartimi i Strategjisë së re të Sigurisë në po të njëjtin vit, por hartimi i Strategjisë së re është iniciuar vetëm gjatë vitit 2017. Deri në muajin maj 2021 Strategjia nuk ka arritur të kompletohet dhe të miratohet si dokument final.

Fusha e emergjencave deri në miratimin e dokumentit të ri, mbetet me dokumentin e vitit 2010 i cili mund të mos pasqyrojë rrethanat e reja në fushën e menaxhimit të emergjencave, sidomos duke marrë parasysh paqartësitë që ekzistojnë në ndarjen e përgjegjësi të palëve kryesore pjesëmarrëse.

¹⁸ Strategjia e Sigurisë e Republikës së Kosovës 2010, ref: <https://bit.ly/3u8MZGk>

¹⁹ Qeveria e Republikës së Kosovës - Analizë e Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë së Republikës së Kosovës, Mars 2014, ref: <https://bit.ly/3yuIx8b>

²⁰ Strategjia e Sigurisë e Republikës së Kosovës 2010, ref: <https://bit.ly/3u8MZGk>

3.1.2. Plani i reagimit kombëtar nuk është azhurnuar që nga viti 2010

Çdo institucion shtetëror, komunat, ndërmarrjet dhe organizatat tjera duhet²¹ të hartojnë planet për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë. Këto plane hartohen për fazat e parandalimit, reagimit dhe rimëkëmbjes të cilat hartohen në bazë të dokumentit “Vlerësimi i Rrezikshmërisë” nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera. Hartimi i këtyre planeve bëhet në bashkëpunim me AME-në dhe ato duhet të rishikohen në baza të rregullta. Impementimi i Planit të Reagimit Kombëtar (PRK) duhet të bëhet katër muaj pas datës së publikimit të tij. Në fund të kësaj periudhe MPB-ja do të bëjë rishikimin një vjeçar për të vlerësuar procesin e implementimit dhe për të bërë rekomandime tek ministri, për përmirësimet e domosdoshme të PRK-së. Në vijim të këtij rishikimi ky dokument do të rishikohet dhe publikohet çdo katër vjet. Ndërsa sipas rregulloreve, PRK-ja duhet të rishikohet cdo dy vite.²²

Plani i reagimit kombëtar është një plan për të gjitha llojet e rreziqeve, i cili siguron strukturë dhe mekanizma për politikat e nivelit kombëtar dhe për koordinim operacional të menaxhimit të incidenteve. Qëllimi i planit është vendosja e qasjes gjithëpërfshirëse kombëtare për menaxhimin e incidenteve ndaj të gjitha rreziqeve në spektrin e plotë të aktiviteteve të parandalimit, gatishmërisë, reagimit dhe rimëkëmbjes.

Plani i reagimit në nivel vendi është hartuar në vitin 2010. PRK-ja deri më tani nuk është rishikuar apo përditësuar. Për këtë qëllim janë dhënë rekomandime nga Qendra e Situatave dhe Ambasada Amerikane.

Edhe pse PRK-ja duhet të rishikohet dhe publikohet së paku çdo katër vjet, sipas vet PRK-së, ndërsa sipas rregullores duhet të rishikohet një herë në çdo dy vjet, sipas përfaqësuesve të AME-së, një kërkesë e tillë nuk ka ardhur deri në muajin Janar 2021 nga institucionet përkatëse as në AME dhe as në MPB dhe nuk e kanë konsideruar të nevojshëm rishikimin e PRK-së.

Plani i reagimit kombëtar nuk ka gjetur zbatueshmëri në shumë intervenime që janë bërë gjatë ndodhjes së fatkeqësisë, sipas vlerësimeve që janë bërë nga Qendra e Situatave drejtuar kryeministrit. Ky plan i pa rishikuar shumicën e rasteve ka vështirësuar punën e institucioneve përgjegjëse si dhe duke vënë në dilemë kompetencat e institucioneve që i kanë garantuar me ligj.

Gjatë auditimit janë vërejtur disa mangësi gjatë zbatueshmërisë së PRK-së për vërshimet e fundit, të cilat janë paraqitur më poshtë:

1. Paqartësi në ndarjen e përgjegjësisë të koordinimit të aktiviteteve tek institucionet e nivelit qendror

Zhvillimi dhe zbatimi i gatishmërisë së emergjencave kërkon mekanizma të fuqishëm koordinimi që përfshijnë pjesëmarrjen multisektoriale dhe partnerët. Koordinimi midis të gjithë partnerëve është thelbësor për çdo aspekt të procesit dhe u mundëson aktorëve të komunitetit, vendas, kombëtar,

21 Rregullore Nr. 08/2013 Për përmbajtjen dhe procedurat e hartimit të planeve të reagimit emergjent1, neni 7, ref: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10170>

22 Rregullore Nr. 08/2013 Për përmbajtjen dhe procedurat e hartimit të planeve të reagimit emergjent1, neni 28, ref: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10170>,

ndërkufitar dhe ndërkombëtar të punojnë drejt objektivave të përbashkëta nën një proces të përbashkët planifikimi. Prioritetet për forcimin e gatishmërisë për emergjencat duhet të përshkruhen qartë në planin e reagimit; përgjegjësit dhe përgjegjësitë e tyre duhet të jenë të identifikuara qartë.²³

Ndër përgjegjësitë e AME-së të përcaktuara në legjislacionin në fuqi²⁴, është edhe përgjegjësia për koordinimin e organizimit të strukturave të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës dhe shërbimeve tjera. Përgjegjësi të tillë për koordinimin e aktiviteteve operacionale²⁵ në tërë Kosovën për menaxhimin e krizave, legjislacioni i përcakton edhe Qendrës së Situatave që funksionon në kuadër të Këshillit të Sigurisë së Kosovës.

AME-ja mbulon pjesën e koordinimit deri sa paraqitet nevoja për mbështetje shtesë, me ç' rast aspekti i koordinimit të kapaciteteve kalon tek Qendra e Situatave ku krijohet grupi operacional për menaxhimin e emergjencës me anëtarë përfaqësues nga institucione relevante, përfshirë edhe AME-në dhe FSK-në.

Të dy institucionet janë të thirrura si koordinatorë në procesin e menaxhimit të emergjencave, por nuk është përcaktuar qartë se për cilat pjesë të koordinimit është përgjegjëse secila. Për këtë qëllim janë dhënë rekomandime nga QS dhe Ambasada Amerikane, por deri në muajin maj 2021 meqenëse nuk është bërë rishikimi i PRK-së kjo çështje nuk është adresuar. Kjo paqartësi ka shkaktuar që palët që kërkojnë ndihmë për raste emergjente të mos jenë të sigurta se te cili institucion të drejtohen për mbështetje ndaj situatave emergjente të vërshimeve.

2. Mungesa e një plani të qartë të komunikimit dhe sistemit të përbashkët të komunikimit mes palëve të përfshira në procesin e reagimit

Udhëheqja në nivelin e incidentit lehtëson komunikimin përmes zhvillimit dhe përdorimit të një plani të përbashkët komunikimi, proceseve të ndëroepimit të komunikimit dhe sistemeve që përfshijnë lidhje me zë dhe të dhëna. Komunikimet e integruara sigurojnë dhe mbajnë kontakte mes burimeve të incidenteve, mundësojnë lidhjen midis niveleve të ndryshme të qeverisjes, arrijnë vetëdijen e situatës dhe lehtësojnë shkëmbimin e informacionit.²⁶

Gjatë reagueve në rastet emergjente kur kërkohet mbështetja e QS-së, qendra merr njoftimin nga njësitet e Policisë së Kosovës (PK) në vend të atyre Njësive reaguese të cilat janë palë reaguese direkte gjatë menaxhimit të rasteve të vërshimeve. Gjithashtu, gjatë intervenimeve të përbashkëta mes PK/NJPZSH/FSK, njësitë e këtyre institucioneve nuk kanë mundësi të komunikimit direkt me njëra tjetrën përmes pajisjeve elektronike²⁷.

23 World Health Organisation 2017, A Strategic Framework for Emergency Preparedness, ref: <https://apps.who.int/iris/bitstream/handle/10665/254883/9789241511827-eng.pdf;jsessionid=2839365893FC6D4A7F6732FC42694C7F?sequence=1>

24 Ligji Nr. 04/L-230 Për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent, ref: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9376>

25 Ligji Nr. 03/L-050 Për Themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës, ref: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2521>

26 Federal Emergency Management Agency, National Incident Management System 2017, ref: https://www.fema.gov/sites/default/files/2020-07/fema_nims_doctrine-2017.pdf

27 Teknologjitë dhe pajisjet portative sigurojnë integrimin efektiv, transportin dhe vendosjen e sistemeve të komunikimit. Kjo përfshin caktimin e standardizuar të kanaleve të radios që ndihmon personelin e incidentit të intervenojë në një incident.

Institucionet reaguese/koordinuese²⁸ nuk kanë një plan të qartë të komunikimit gjatë menaxhimit të emergjencave si dhe nuk ka sistem të përbashkët të komunikimit për të gjitha palët reaguese në incident.

Mungesa e planit të komunikimit e zgjatë zingjirin e komunikimit në mënyrë të panevojshme, duke shkaktuar vonesa në procesin e reagimit ndaj emergjencave të paraqitura. Ndërsa mungesa e sistemit të përbashkët të komunikimit e pamundëson komunikimin në distancë mes njësive duke e vështirësuar procesin e reagimit. Si në rastin e vërshimeve të janarit 2021, komuna e Gjakovës ka kërkuar ndihmë përmes emaili- it nga AME-ja për mjete teknike, ndërsa kësaj kërkesë AME-ja nuk ka arritur t'i përgjigjet.

Në vitin 2011, ka filluar përgatitja për projektin për "Sistemin e Integruar të Komunikimit në Sektorin e Sigurisë", nga Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës, por deri në muajin maj 2021, ky sistem nuk është kompletuar.

3. Mungesa e përcaktimit të qartë dhe transferit të Komandës së Incidentit gjatë reagimeve të përbashkëta

*Komanda e Përbashkët përmirëson unitetin e përpjekjeve në menaxhimin e incidenteve multi-juridiksionale ose shumë-agjencie. Përdorimi i Komandës së Unifikuar u mundëson juridiksioneve dhe atyre me autoritet ose përgjegjësi funksionale për incidentin që së bashku të menaxhojnë dhe drejtojnë aktivitetet e incidentit përmes krijimit të një grupi të përbashkët të objektivave të incidentit, strategjive dhe veprimeve të unifikuara të reagimit. Sidoqoftë, secili partner pjesëmarrës mban autoritetin, përgjegjësinë dhe llogaridhënien për personelin e tij dhe burimet e tjera dhe secili anëtar i komandës së unifikuar është përgjegjës për mbajtjen e anëtarëve të tjerë të komandës së unifikuar të informuar.*²⁹ *Me rastin e transferit të komandës, procesi duhet të përfshijë brifingun (udhëzimet me të gjitha informacionet esenciale) për vazhdimin e operacioneve të sigurta dhe efektive.*³⁰

Komanda e Incidentit ka përgjegjësi për të gjitha aktivitetet në incident, përfshirë zhvillimin e strategjive dhe taktikave si dhe porositjen dhe lirimimin e resurseve. Gjithashtu kjo Komandë, ka përgjegjësinë dhe autoritetin e plotë për zhvillimin e operacioneve në incident dhe është përgjegjëse për menaxhimin e të gjitha operacioneve në vendin e ngjarjes.

Në dy komunat e përzgjedhura në këtë auditim, gjatë ndërhyrjeve të përbashkëta FSK/NJPZSH, nuk ka pasur përcaktim të qartë të Komandës së Incidentit apo transferim formal të Komandës si dhe nuk ka pasur të caktuar Komandë të Përbashkët për njësitë reaguese. Mungesa e përcaktimit të qartë të Komandës së Incidentit gjatë reagimeve të përbashkëta ka ardhur si rezultat i mungesës së një plani të qartë që jep udhëzimet e nevojshme se si të bëhet përcaktimi dhe transferi i Komandës së Incidentit gjatë këtyre reagimeve.

Si pasojë, palët reaguese kanë vepruar në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra gjatë incidenteve, gjë që e ka vështirësuar procesin e reagimit të përbashkët, njëkohësisht duke vështirësuar koordinimin dhe komunikimin mes palëve të përfshira në reagim.

²⁸ AME, NJPZSH, FSK, PK

²⁹ Federal Emergency Management Agency, National Incident Management System 2017, ref: https://www.fema.gov/sites/default/files/2020-07/fema_nims_doctrine-2017.pdf

³⁰ Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave 2010, ref: <https://ame.rks-gov.net/content/templates/ame/uploads/2020-10/SIME%20i%20Miratuar.pdf>

3.2. Vlerësimi i rrezikut në nivel vendi dhe të dhënat historike mbi fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera

3.2.1. Dokumenti i vlerësimit të rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në nivel vendi nuk është përditësuar që nga viti 2016

Vlerësimi i rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera identifikon kërcënimet nga rreziqet në Republikën e Kosovës, si dhe vlerësimin e shkallës së rrezikshmërisë së tyre. AME-ja obligohet të bëjë vlerësimin e rrezikshmërisë së popullatës, të mirave materiale, kulturore dhe mjedisit nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në nivel vendi çdo tre vjet apo sipas nevojës edhe më shpesh. Bartësit tjerë të vlerësimit, në këtë rast komunat, janë të obliguar që vlerësimet e tyre t'i harmonizojnë me vlerësimin në nivel vendi.³¹

Agjencia e Menaxhimit Emergjent

AME-ja obligohet të bëjë vlerësimin e rrezikshmërisë së popullatës, të mirave materiale, kulturore dhe mjedisit nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në nivel vendi. Vlerësimi i rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në nivel vendi i punuar nga MPB-ja në bashkëpunim me AME-në është publikuar në Korrik 2016. Në këtë raport është përfshirë edhe vlerësimi i rreziqeve nga vërshimet, ku sipas raportit vërshimet e fundit kanë ndodhur në Prill 2014. Ky raport përmban hartat ku tregohen zonat e prekura nga vërshimet, shkaqet kryesore të vërshimeve në Kosovë, faktorët e përkeqësimit, skenarët e mundshëm, pasojat, periudhat e rrezikut nga vërshimet, etj.

Sipas planit vjetor të punës së AME-së për vitin 2021, është planifikuar që të krijohet grupi punues të cilët do të bëjnë vlerësimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në nivel vendi ku pritet të përfundohet deri në fund të vitit 2021. Nga viti 2016, nuk është bërë përditësimi i dokumentit mbi vlerësimin e rrezikut në nivel vendi nga AME-ja.

Sipas institucionit, arsyeja pse nuk është hartuar një plan i vlerësimit të rrezikut në nivel vendi këto vitet e fundit ka qenë pritja e ndryshimit të rregullores për metodologjinë e hartimit të vlerësimit të rrezikshmërisë e cila ka hy në fuqi me 24 nëntor 2020. Edhe pse në planin e punës së AME-së për vitin 2019 dhe 2020 ka qenë i paraparë ndryshimi i kësaj rregullore, është vonuar për shkak të ndryshimit të shpeshtë të qeverisë dhe shfaqja e pandemisë Covid-19. Tashmë janë në proces të themelimit të grupit punues për hartimin e rishikimit të dokumentit të vlerësimit.

Vlerësimi i rrezikut në nivel vendi si pjesë kyçe për parandalimin e një fatkeqësie në vend, nëse nuk përditësohet më shpesh, pamundëson parashikimin e fatkeqësive dhe pasojave të mundshme nga fatkeqësia, si dhe pamundëson të propozohet niveli i duhur i mbrojtjes

³¹ Rregullore Nr. 28/2012 Për metodologjinë e hartimit të vlerësimit të rrezikshmërisë, neni 19, ref: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10293>

nga rreziqet përkatëse dhe masat parandaluese për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë. Bartësve tjerë të vlerësimit të cilët janë të obliguar që vlerësimet e tyre t'i harmonizojnë me vlerësimin nivel vendi nuk mund të nxjerrin konkluzione të sakta për llojet e fatkeqësive që i kanosen komunitetit komunal.

3.2.2. Të dhënat historike mbi fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera nuk janë të plota

Databaza DesInventar (disaster inventory system) me të dhëna historike është një mjet që ndihmon për të analizuar trendet e katastrofës dhe ndikimet e tyre në një mënyrë sistematike. Me një kuptim të shtuar të tendencave të katastrofës dhe ndikimeve të tyre, mund të planifikohen masa më të mira parandalimi, zbutjeje dhe gatishmërie për të zvogëluar ndikimin e katastrofave në komunitet.³²

Departamenti i parandalimit në kuadër të AME-së ka për qëllim zvogëlimin e rreziqeve që mund ti kanosen vendit nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera. Njëra nga mënyrat se si bëhet ky parandalim është përmes vlerësimit të rrezikut, duke u bazuar edhe në të dhëna historike. Databaza e fundit me të dhëna historike "Desinventar Kosova" është krijuar në vitin 2015 e cila pasqyron rreziqet kryesore nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në Kosovë. Përmes kësaj databaze mund të planifikohen veprime më të mira të parandalimit duke analizuar trendet e katastrofës dhe ndikimet e tyre në një mënyrë sistematike. Databaza është plotësuar dhe përditësuar me të dhëna në vitin 2019 nga tetë komuna të cilat kanë dërguar informata mbi fatkeqësitë që kanë ndodhur, mirëpo nuk është plotësuar për tërë komunat e Kosovës. Përderisa, për vitin 2020 nuk ka të dhëna në sistem.

Databaza DesInventar është në funksion dhe është e çasshme vetëm brenda rrjetit qeveritar, megjithatë mungojnë të dhënat e plota në këtë databazë për të gjitha komunat për vitet 2019 dhe 2020. Kjo ka ardhur si rezultat i mos raportimit të të gjitha komunave në Sistemin e Unifikuar të Raportimit Statistikor (SURS) që shërben për evidentimin e të gjitha incidenteve dhe raportimin e tyre në nivel regional dhe qendror. Komuna e Gjakovës përcjell të dhënat mbi fatkeqësitë që ndodhin në qendrën operative të Pejës, kurse përmes sistemit të unifikuar të raportimit statistikor (SURS) raportohet drejtpërdrejtë në AME. Nga ana tjetër komuna e Vushtrrisë nuk përdor sistemin SURS për regjistrimin e këtyre të dhënave në mungesë të trajnimeve lidhur me përdorimin e këtij sistemi.

Mungesa e të dhënave mbi fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në Kosovë paraqet problem për vlerësime të rrezikut në të ardhmen duke mos qenë të informuar se si dhe ku kanë ndodhur këto fatkeqësi. Mungesa e të dhënave të plota në databazën DesInventar dhe sistemin SURS, ka shkaktuar vështirësi në pasqyrimin e gjendjes së përgjithshme mbi fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

³² Sistemi DesInventar, ref: http://desinventar.cimafoundation.org/what_is.html

3.3. Monitorimi i aktiviteteve të parandalimit dhe reagimit nga fatkeqësitë natyrore dhe matja e përfomancës së Njësive Zjarrfikëse

3.3.1. Mungesa e monitorimit të aktiviteteve të parandalimit dhe reagimit nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera

Komunat duhet³³ të hartojnë planet për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë. Këto plane hartohen për fazat e parandalimit, reagimit dhe rimëkëmbjes të cilat hartohen në bazë të dokumentit “Vlerësimi i Rrezikshmërisë” nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera. Hartimi i këtyre planeve bëhet në bashkëpunim me AME-në dhe ato duhet të rishikohen në baza të rregullta³⁴. Për rastet të cilat nuk zbatojnë këto masa parashihen ndëshkime me gjobë për shkelje të masave mbrojtëse ndaj fatkeqësive³⁵ sipas nivelit të shkeljes.

AME-ja nuk ka bërë verifikimin e gjendjes në komuna mbi posedimin e dokumentit të rrezikut dhe planit të reagimit.

Vizita e fundit nga ana e AME-ja tek komunat për rishikimin e dokumentit mbi vlerësimin e rrezikshmërisë ka qenë në vitin 2018. Të dhënat nga raporti janë paraqitur në tabelën më poshtë:

Tabela 1: Rishikimi i dokumentit mbi vlerësimin e rrezikshmërisë nga AME për komunat

Dokumenti i vlerësimit të rrezikut	Vizita në 38 komuna gjatë vitit 2018
I hartuar dhe aprovuar	4 komuna
I hartuar dhe i pa aprovuar	4 komuna
I hartuar dhe i përditësuar	8 komuna
I hartuar dhe i pa përditësuar	13 komuna
I pa hartuar	9 komuna

³³ Rregullore Nr. 08/2013 Për përmbajtjen dhe procedurat e hartimit të planeve të reagimit emergjent¹, neni 7, ref: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10170>

³⁴ Rregullore Nr. 08/2013 Për përmbajtjen dhe procedurat e hartimit të planeve të reagimit emergjent¹, neni 21, ref: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12509>,

³⁵ Ligji nr. 04/-L-027 Për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera, neni 116-119, Ref: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2775>

Qëllimi i kësaj vizite ka qenë vlerësimi dhe analizimi i gjendjes në fushën e parandalimit dhe hartimi si dhe unifikimi i dokumenteve të nivelit lokal në përputhje me ligjet, rregulloret dhe udhëzimet administrative në fuqi. Gjithashtu janë trajtuar, analizuar dhe vlerësuar edhe këto fusha: struktura organizative, plotësimi me staf dhe funksionimi i drejtorive përkatëse në fushën e parandalimit, organizmit, gatishmërisë dhe funksionimi i strukturave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë në nivel lokal.

Analiza jonë përmes pyetësorit të dërguar 38 komunave, prej të cilave kemi pranuar përgjigje nga 35 komuna, ndërsa komunat Prizren, Pejë dhe Istog nuk janë përgjigjur, gjatë fundvitit 2020 lidhur me dokumentet për vlerësimin e rrezikut në nivel lokal dhe planet për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë, është paraqitur më poshtë:

Tabela 2: Analiza e ZKA mbi dokumentet për vlerësim të rreziqeve të hartuara nga komunat.

Dokumenti	Analiza nga pyetësori i dërguar 35 komunave
Kanë hartuar dokumentin për vlerësimin e rrezikshmërisë	6 komuna
Kanë hartuar planin për mbrojtje, ndihmë dhe shpëtim	2 komuna
Kanë hartuar dokumentin për vlerësimin e rrezikshmërisë dhe planin për mbrojtje, ndihmë dhe shpëtim	20 komuna
Nuk kanë vlerësuar rrezikshmërinë dhe nuk kanë hartuar planin për mbrojtje, ndihmë dhe shpëtim	7 komuna

Përmes këtij pyetësori kemi kuptuar se cilat dokumente i posedojnë komunat aktualisht, sa i përket parandalimit dhe reagimit të situatave emergjente.

Që nga viti 2018, AME-ja nuk ka siguruar informata për komunat mbi gjendjen e posedimit të dokumenteve bazë mbi parandalimin e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera.

Nuk janë marrë masat që parashihen me ligj, siç është ndëshkimi me gjobë për komunat që nuk kanë bërë vlerësimin e rrezikut dhe hartimin e planeve për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë. Kjo ka ardhur si shkak i mosplotësimit të pozitës së kryeinspektorit nga ana e AME-së edhe pse sipas planit të personelit për vitin 2020 ka qenë e paraparë edhe kjo pozitë.

Mosfunksionimi i departamentit të inspektorëve ka shkaktuar mungesë monitorimi dhe ndëshkimi tek komunat që nuk kanë hartuar planet operative emergjente komunale.


3.3.2. Mungesa e matjes së performancës të Njësive Profesionale për Zjarrfikje dhe Shpëtim

Matja e performancës është e nevojshme për të lejuar njësitë të përcaktojnë një nivel bazë të performancës sipas treguesve; për të vendosur qëllime të bazuara në performancën aktuale; për të përcaktuar hendekun midis qëllimeve të dëshiruara dhe niveleve aktuale të performancës; për të ndjekur progresin drejt arritjes së qëllimeve; për të krahasuar performancën ndërmjet njësive; për të identifikuar problemet dhe shkaqet eventuale; dhe për të planifikuar për të ardhmen. Matja e njësive të zjarrfikësve sipas të njëjtëve tregues, mundëson që praktikatat e mira të zbatohen më lehtë.³⁶ Ministria e Punëve të Brendshme duhet të kryej mbikëqyrjen e ushtrimit të detyrave të agjencisë dhe njësive të zjarrfikjes dhe shpëtimit që veprojnë në komuna.³⁷

Njësitë Profesionale për Zjarrfikje dhe Shpëtim (NJPZSH) janë ndër reaguesit e parë për dhënie të ndihmës dhe shpëtimit në rastet e vërshimeve. Menaxhimi³⁸ i këtyre njësive bëhet nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent (AME) në bashkëpunim me komunat përkatëse ku ndodhen këto njësi. Këto njësi raportojnë në baza mujore dhe vjetore tek Departamenti për Zjarrë dhe Shpëtim në AME.

Numri i intervenimeve të zjarrfikësve për raste të vërshimeve sipas regjioneve për vitet 2019 – Janar 2021 është paraqitur në grafikun 3.

Grafiku 2: Intervenimet e NJPZSH sipas regjioneve³⁹



³⁶ National Fire Protection Association - Fire Department Operational Performance Measures, ref:

<https://nfpa.org/-/media/Files/Membership/member-sections/Metro-Chiefs/Urban-FireForum/2018/2018UFFPerformanceMeasures.ashx>

³⁷ Ligji Nr. 04/-L-049 Për Zjarrfikje dhe Shpëtim, Neni 4, ref: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2778>

³⁸ Ligji Nr. 04/-L-049 Për Zjarrfikje dhe Shpëtim, Neni 7, ref: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2778>

³⁹ Informata nga AME-ja

Intervenimet e zjarrfikësve për rastet e vërshimeve gjatë vitit 2020 u rritën për 67% krahasuar me vitin 2019, ndërsa vetëm gjatë muajit janar të vitit 2021, numri i intervenimeve për rastet e vërshimeve u rrit në mënyrë drastike krahasuar me vitet e kaluara. Regjionet me intervenimet më të shpeshta për rastet e vërshimeve brenda periudhës 2019 - janar 2021 ishin regjioni i Gjakovës dhe ai i Mitrovicës (përkatësisht Komuna e Vushtrrisë).

Për periudhën 2019-2020, nuk është bërë matje e nivelit të performancës së këtyre njësive sipas treguesve të përcaktuar. Megjithatë, AME-ja ka zhvilluar vizita me qëllim të monitorimit të njësive të caktuara, të cilat janë parë si të mjaftueshme për këtë qëllim, mirëpo nuk është bërë një matje e tillë e performancës për të gjitha njësitë, e cila është e rëndësishme për të identifikuar problemet dhe shkaqet eventuale dhe për të planifikuar për të ardhmen.

Në mungesë të matjes së performancës, devijimet e njësive të zjarrfikësve në lidhje me intervenimet mund të kalojnë pa u vërejtur dhe për to mund të mos ndërmerren veprimet e nevojshme korrigjuese.

3.3.3. Mungesa e raporteve pas veprimit

Komanda e Incidentit ndër funksionet e veta ka edhe nxjerrjen e mësimave të marra nga situata e menaxhuar përmes raporteve të vlerësimit pas incidentit. Ndërsa përpjekja për menaxhimin e incidenteve evoluon, koha shtesë e drejtimit, personeli, sistemet e informacionit dhe teknologjitë mundësojnë planifikim dhe katalogim më të hollësishëm të ngjarjeve dhe mësimave të marra⁴⁰

Procesi i reagimit zakonisht ndodh në mënyrë të menjëhershme, me disa palë të përfshira në mënyrë që të arrihet minimizimi i dëmeve të shkaktuara. Pas procesit të reagimit, përmes raporteve të vlerësimit identifikohen mangësitë që e kanë përcjellë procesin si dhe jepen rekomandimet për përmirësimin e këtyre mangësive.

Komuna e Vushtrrisë dhe e Gjakovës nuk kanë arritur të përpilojnë raporte të vlerësimit për ndërhyrjet e bëra për rastet e vërshimeve 2019 - Janar 2021. Deri më tani nuk është parë si e nevojshme të përpilohen raporte të tilla.

Mungesa e raporteve të vlerësimit pas reagimit për raste të vërshimeve bënë që mangësitë të mos adresohen fare dhe as të mos merren veprime korrigjuese për to.

⁴⁰ Federal Emergency Management Agency, National Incident Management System 2017, ref: https://www.fema.gov/sites/default/files/2020-07/fema_nims_doctrine-2017.pdf

3.3.4. Dokumenti i vlerësimit të rrezikut dhe plani për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë nuk janë dërguar për miratim në Kuvendin Komunal

Komunat, duhet⁴¹ të hartojnë planet për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë. Këto plane hartohen për fazat e parandalimit, reagimit dhe rimëkëmbjes të cilat hartohen në bazë të dokumentit “Vlerësimi i Rrezikshmërisë” nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera. Komunat janë të obliguara që vlerësimet e tyre të rrezikut t’i harmonizojnë me vlerësimin e rrezikut në nivel vendi. Vlerësimin e rrezikut në nivel lokal e harton organi kompetent komunal, në formë drafti, të cilin e dërgon në AME për shqyrtim profesional dhe përmbajtësor, merr opinion nga AME-ja dhe pastaj procedohet për miratim⁴² në Kuvendin Komunal.⁴³

Komuna e Gjakovës

Në kuadër të komunës së Gjakovës funksionon Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim (DMSH) ku njëra nga shumë përgjegjësitë e kësaj drejtorie është të identifikojë, analizojë dhe vlerësojë rreziqet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore. Gjatë vitit 2009, kjo drejtori ka marrë pjesë në trajnimin e mbajtur nga AME-ja lidhur me hartimin e dokumentit për vlerësimin e rreziqeve. Nga ky trajnim është hartuar dokumenti i vlerësimit të rrezikut në harmonizim me dokumentin në nivel vendi i vitit 2009. Sipas AME-së gjatë vizitës në komunën e Gjakovës në vitin 2018, drejtoria në këtë komunë posedon dokumentin e vlerësimit të rrezikshmërisë të hartuar dhe të aprovuar nga Kuvendi Komunal në vitin 2012, ndërsa në vitin 2018 është bërë rifreskimi i tij.

DMSH-ja ka raportuar edhe mbi pikat kritike në lumenjtë Erenik, Krena dhe Llukac duke sqaruar historikun e lokacionit mbi rreziqet e shfaqura dhe duke dhënë rekomandim se si të veprohet më tutje dhe cilat masa të sigurisë duhet ndërmarr. Gjithashtu ky raport shpalos shkaqet dhe karakteristikat e përgjithshme të vërshimeve në komunën e Gjakovës. Bazuar në vlerësimet e rreziqeve si dhe zvogëlimin e tyre është realizuar projekti për ndërtimin e murit në lumin Krena në vitin 2015. Komuna e Gjakovës, me përkrahje financiare dhe ekzekutim të punimeve nga ana e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, kan arritur që të rehabilitoj bregun e lumit Krena me ndërtimin e mureve mbrojtëse (punime të realizuara gjatë viteve 2015-2017).

Gjatë vitit 2018-2019 janë ndërmarr masa nga DMSH-ja për parandalimin e vërshimeve janë lokacione të cilat janë vlerësuar si më kritike dhe me potencial vërshimi. Po ashtu në vitin 2020, përmes kontraktimit të operatorit ekonomik është intervenuar në pikat më kritike për parandalimin e vërshimeve përgjatë lumit Krena dhe Llukac. Dokumenti i vlerësimit të rrezikut edhe pse i përditësuar në vitin 2019, nuk është dërguar në kuvendin komunal për miratim.

41 Rregullore Nr. 08/2013 Për përmbajtjen dhe procedurat e hartimit të planeve të reagimit emergjent1, neni 7, ref: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10170>

42 Ligji për vetëqeverisjen locale, neni 12, ref: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>

43 Rregullore Nr. 28/2012 Për metodologjinë e hartimit të vlerësimit të rrezikshmërisë, neni 17, ref: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10293>

Komuna e Gjakovës ka përditësuar planin e reagimit në vitin 2018. Ky plan përmban informatat mbi parashikimet dhe konsideratat për planifikim, rolet dhe përgjegjësitë në menaxhimin e situatave emergjente, subjektet për reagim emergjent, etj. Ky plan është hartuar për fazat e parandalimit, reagimit dhe rimëkëmbjes. Një pjesë e këtij plani është hartuar në bashkëpunim me AME-në. Edhe pse nuk është përditësuar që 3 vite, nga pjesa operative ky plan është funksional, ndërsa nga pjesa e personelit ka pësuar ndryshime të cilat nuk janë përditësuar ende. Edhe pse komuna e Gjakovës ka përditësuar dokumentin e vlerësimit të rrezikut në vitin 2019 dhe Planin e reagimit komunal në vitin 2018, këto dokumente nuk janë dërguar për miratim në Kuvendin Komunal.

Në mungesë të pozitës së punës së inspektoratit për fatkeqësi natyrore, nuk është shqiptuar asnjë masë detyrimore ndaj institucioneve publike dhe ndërmarrjeve private në komunë të cilat nuk posedojnë këto dokumente. Hartimi i këtyre dokumenteve bëhet duke inkorporuar edhe Vlerësimet e Rreziqeve dhe Planeve të Reagimit të enteve, institucioneve, ndërmarrjeve, ekonomisë së biznesit, OJQ-ve dhe sferave e subjekteve tjera. Ndaj, komuna në hartimin e këtyre dokumenteve ka vepruar në mënyrë unilaterale duke i shfrytëzuar të dhënat vetanake dhe pa informacionet e institucioneve tjera brenda komunës, duke mos qenë të kompletuara siç duhet. Për këtë arsye nuk janë dërguar për miratim në Kuvendin Komunal.

Dokumentet e pa miratuara nga Kuvendi Komunal nuk mund të jenë efektive në zbatimin e tyre. Kërkesat që mund ti ketë plani i reagimit komunal duke u bazuar nga dokumenti i vlerësimit të rrezikut nuk mund të realizohen nëse nuk miratohet nga komuna.

Komuna e Vushtrrisë

Në kuadër të komunës së Vushtrrisë funksionon Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim (DMSH) ku njëra nga shumë përgjegjësitë e kësaj drejtorie është të bëjë vlerësimin e shkallës së rrezikshmërisë në komunë dhe njëkohësisht të ndërmarr masa për parandalimin dhe evitimin e rrezikshmërisë. Me plan të punës së DMSH-së për vitin 2019, është paraparë përditësimi i dokumentit për vlerësimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera. Dokumenti i vlerësimit të rrezikut në komunën e Vushtrrisë është hartuar në vitin 2014. Ky dokument përmban informata të shumta dhe vlerësime të rrezikut nga vërshimet, thatësitë, fatkeqësitë tekniko-teknologjike, nga zjarret në objekte banimi dhe zjarre fushore, ndotja e ambientit dhe gjithashtu edhe masat preventive për këto rreziqe. Në këtë dokument është përfshirë edhe harta e komunës së Vushtrrisë, harta për lumenjtë në Vushtrri, harta për shtrirjen e maleve, harta e zonave maksimalisht të rrezikuara nga tërmetet në Kosovë, harta për vendbanimet dhe shtrirja e popullsisë, hartat që tregojnë zonat e tokës bujqësore, harta mbi lokacionet dhe objektet industriale, harta që tregon vendbanimet që janë të rrezikuara nga vërshimet. Në këtë dokument janë paraparë edhe strehimoret për strehim të përkohshëm në raste emergjente.

Me plan të punës së DMSH-së për vitin 2019, është paraparë hartimi i planit për reagimin emergjent. Ky plan është përditësuar në vitin 2020 dhe përmban informata mbi strukturën e organizimit, ekipet e reagimit në emergjencë, përgjegjësinë kryesore dhe suazat e përgjegjësisë për t'i përgjigjur veprimeve etj. Edhe pse ekziston një dokument ku janë paraqitur vlerësimet e rrezikut në nivelin komunal dhe plani i reagimit është përditësuar në vitin 2018, këto dokumente nuk janë dërguar për miratim në kuvendin komunal.

Dokumenti i vlerësimit të rrezikut në nivelin komunal nëse nuk përditësohet të paktën çdo 3 vjet, nuk është funksional dhe operativ duke marrë parasysh se ndryshon numri i banorëve, numri i vendbanimeve, infrastruktura rrugore, infrastruktura teknologjike dhe e komunikacionit, rrugët urbane brenda qytetit, gjendja e resurseve ujore-lumore, etj. Dokumentet e pa miratuara nga Kuvendi Komunal nuk mund të jenë efektive në zbatimin e tyre. Kërkesat që mund t'i ketë plani i reagimit komunal duke u bazuar nga dokumenti i vlerësimi i rrezikut nuk mund të realizohen nëse nuk miratohet nga komuna.

3.4. Burimet njerëzore dhe teknike për reagim ndaj situatave emergjente

3.4.1. Pamjaftueshmëri e burimeve njerëzore dhe teknike për reagim ndaj situatave emergjente dhe mos verifikimi i aftësisë psiko-fizike të personave në NJPZSH

AME-ja dhe institucionet e tjera duhet të sigurojnë burimet e nevojshme për menaxhimin e situatave emergjente.⁴⁴ Njësitë profesionale të zjarrfikjes dhe shpëtimit, mund të ndryshojnë në raport me vlerësimin e rrezikshmërisë në aspektin e mbrojtjes nga zjarri si dhe numrit të banorëve në zonat përkatëse të përgjegjësisë. Caktimi i numrit të zjarrfikësve mund të bëhet edhe sipas numrit të banorëve dhe atë për çdo 1500 banorë duhet të ketë së paku një zjarrfikës profesional.⁴⁵ Nëse forcat dhe resurset në dispozicion janë të pamjaftueshme për t'u përballur me operacionet e domosdoshme të shpëtimit dhe ndihmës, atëherë, mund të kërkohet dislokimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe resurset e tyre për mbrojtje.⁴⁶ AME-ja duhet të ketë të funksionalizuar Njësinë për intervenime të specializuara të strukturave të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës së nivelit qendror për shpëtim nga ujërat.⁴⁷

44 Plani i Reagimit Kombëtarë, fq.100, Ref: https://ame.rks-gov.net/Portals/0/Files/Plani%20Reagimit%20Kombetar_14_01_11.pdf

45 Rregullore Nr. 16/2012 për strukturën organizative të njësive profesionale të zjarrfikjes dhe shpëtimit, neni 14, ref: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8381>


46 Ligji Nr. 04/-L-027 Për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, Neni 15, ref: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2775>

47 Rregullore (QRK) - Nr. 18/2015 Për Organizimin e Njësive të Strukturave për Mbrojtje, Shpëtim dhe Ndihmë, Shtojca Nr.2, ref: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=35697>

Burimet njerëzore

Në Kosovë janë 35 stacione zjarrfikëse të vendosura në 34 komuna, ku 2 prej tyre për shkak të madhësisë së qytetit janë në Prishtinë. Deri më tani, (janar 2021), janë të punësuar 766 zjarrfikës në tërë territorin e Kosovës. Në kuadër të zjarrfikësve ekzistojnë ekipet apo skuadrat e pompimit me kapacitet të lartë (10 persona), kontrollim të vërshimeve (11 persona), kërkim shpëtimit me barkë (11 persona aktiv dhe 3 rezervë), që merren me rastet e vërshimeve. Figura më poshtë paraqet hartën se në cilat qytete shtrihen stacionet e zjarrfikësve.

Fig 2. Shtrirja e Njësive profesionale të zjarrfikjes dhe shpëtimit në nivel vendi



Me vendim të Qeverisë në vitin 2013 është bërë transferimi i njësisë profesionale të zjarrfikjes dhe shpëtimit nga niveli lokal – komunat në nivelin Qendror – AME/MPB. Mirëpo, edhe pse me vendim ceket që AME/MPB obligohet të buxhetojë NJPZSh-në në kuadër të saj, ky personel ende vazhdon të paguhet dhe këto paga vendosen nga komunat, mirëpo njësia menaxhohet

nga AME-ja në koordinim me komunat. Komunat kanë paraqitur kërkesë për rritjen e stafit të zjarrfikësve duke arsyetuar se me stafin aktual është e pamundur ngritja e gatishmërisë reaguese në nivel më të lartë, pamundësia për dërgimin e zjarrfikësve në trajnime shitesë për shkak të stafit të pamjaftueshëm dhe shumë vështirësi tjera.

Niveli qendror organizon njësi të strukturave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë për intervenime të specializuara siç janë njësia për mbrojtje dhe shpëtim nga ujërat⁴⁸. Plotësimin, sistemimin, aftësimin, pajisjen dhe përdorimin e këtyre njësive e bën AME-ja. Aktualisht këto njësi janë pjesë e zjarrfikësve dhe e kanë si punë sekondare pjesën e shpëtimit në ujëra. Nga ana tjetër, FSK-ja ka njësinë për Kërkim-Shpëtim në Ujëra, e cila për momentin, është e vetmja njësi reaguese që merret edhe me pjesën e kërkim-shpëtimit në ujëra të thella (zhytje). FSK-ja ka ndërhyrë si reagues i parë për operacione të kërkim shpëtimit në ujëra në dymbëdhjetë (12) raste të vërshimeve gjatë muajit janar 2021. Gjatë vitit 2019 dhe 2020 nuk ka pasur raste të vërshimeve ku është kërkuar ndërhyrja e FSK-së.

Sipas ligjit⁴⁹ në fuqi duhet të jenë 1188 zjarrfikës të trajnuar dhe të gatshëm për reagim, bazuar në numrin e banorëve rezidentë⁵⁰. Aktualisht janë 766 zjarrfikës aktivë në tërë territorin e Kosovës.

48 Rregullore (QRK) - Nr. 18/2015 Për Organizimin e Njësive të Strukturave për Mbrojtje, Shpëtim dhe Ndihmë, neni 6 ref: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=35697>

49 Rregullore Nr. 16/2012 për strukturën organizative të njësive profesionale të zjarrfikjes dhe shpëtimit, neni 14, ref: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8381>

50 Vlersimi i popullsisë për vitin 2019, ref: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/vleresimi-i-popullsise-2019>

Qendra operative në **komunën e Gjakovës** funksionon në kuadër të regjionit të Pejës.

Në kuadër të NJPZSh-së **nuk ka** zjarrfikës të specializuar për **shpëtim në ujëra.**



Komuna e Gjakovës gjatë vitit 2020 ka kërkuar nga Ministria e Financave **rritje të numrit të stafit,** kryesisht **numrin e zjarrfikësve.**

Për çdo **1500 banorë** së paku duhet një **zjarrfikës profesional.**



Komuna e Gjakovës kishte **43 zjarrfikës** aktivë, ndërsa nëse i referohemi ligjit⁵¹ në fuqi,



komuna duhet të ketë 62 zjarrfikës të trajnuar dhe të gatshëm për reagim, bazuar në numrin e banorëve rezidentë⁵² në këtë komunë.

51 Rregullore Nr. 16/2012 për strukturën organizative të njësive profesionale të zjarrfikjes dhe shpëtimit, neni 14, ref: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8381>

52 Vlersimi i popullsisë për vitin 2019, ref: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/vleresimi-i-popullsisë-2019>

Qendra operative në **komunën e Vushtrrisë** funksionon në kuadër të regjionit të Mitrovicës.

Në kuadër të NJPZSh-së **nuk ka zjarrfikës të specializuar** për **shpëtim në ujëra.**



Deri në janar 2021 **kishte 31 zjarrfikës** aktivë, ndërsa nëse i referohemi ligjit në fuqi,



komuna duhet të ketë 41 zjarrfikës të trajnuar dhe të gatshëm për reagim, bazuar në numrin e banorëve rezidentë⁵³ në këtë komunë.

AME-ja nuk ka poseduar kapacitetet e nevojshme njerëzore për të kryer aktivitetet e kërkim-shpëtimit pa asistencën e njësive të FSK-së. Edhe pse ka pasur kërkesë për rritjen e numrit të zjarrfikësve nga komunat, kjo nuk është realizuar për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore.

Mungesa e kapaciteteve njerëzore e bën të pamundur ngritjen e gatishmërisë reaguese në nivel më të lartë dhe vështirëson operimin dhe reagimin e shpejt dhe efikas në rast të fatkeqësive natyrore apo fatkeqësive tjera.

Verifikimi i aftësisë psiko-fizike të personave në NJPZSH

NJPZSh-ve duhet t'ju bëhet çdo vit verifikimi i aftësisë psiko fizike që nënkupton aftësinë shëndetësore, mendore dhe aftësinë fizike. Komandanti i NJPZSh-së është i obliguar të organizojë, mbikqyrë dhe evidentojë kryerjen e kontrolleve të rregullta shëndetësore⁵⁴. Kontrollat dhe ekzaminimet për të gjitha

⁵³ Vlersimi i popullsisë për vitin 2019, ref: <https://ask.rks-gov.net/sq/agjencia-e-statistikave-te-kosoves/add-news/vleresimi-i-popullsisë-2019>

⁵⁴ Udhëzim administrativ Nr. 39/2012-MPB për përcaktimin e kriterëve për aftësitë psiko-fizike të zjarrfikësve, neni 4, ref: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9756>

kategoritë e zjarrfikësve përcaktohen me marrëveshjen e lidhur midis MPB-së dhe Institutit të Mjekësisë së Punës⁵⁵.

Në komunën e Gjakovës dhe të Vushtrisë nuk kanë verifikuar çdo vit aftësinë psiko-fizike të personave në NJPZSh për të vlerësuar aftësinë shëndetësore, mendore dhe fizike për të kryer punët e zjarrfikësit.

Deri në janar 2021 nuk kishte marrëveshje ndërmjet MPB-së dhe Institutit të Mjekësisë së Punës për kontrollet dhe ekzaminimet për të gjitha kategoritë e zjarrfikësve. Përderisa kjo marrëveshje nuk ekziston është e pamundur që kjo kontrollë të bëhet edhe nëse bën kërkesë komandanti i NJPZSh-së.

Mosvlerësimi i aftësisë psiko-fizike të zjarrfikësve mund të paraqes probleme në kryerjen e punëve gjatë reagimit emergjent. Këto vlerësime konstatojnë se personi i kontrolluar mund apo nuk mund të kryejë punët dhe obligimet e zjarrfikësit, duke cekur se cilat obligime apo punë kufizohet të kryejë.

Kapacitetet teknike

Për të ushtruar veprimtarinë për zjarrfikje dhe shpëtim, zjarrfikësit duhet të posedojnë pajisje personale dhe të përbashkëta mbrojtëse, pajisje teknike dhe mjete për zjarrfikje dhe shpëtim.⁵⁶

Janë rreth **241 automjete për fikjen e zjarrit** në të gjitha NJPZSh-të e Kosovës



- **96** janë në **gjendje të rregullt**,
- **47** janë me **defekte të vogla**,
- **31** me **defekte të konsiderueshme**,
- **40** të **gatshme pas riparimit** dhe
- **27** janë **jashtë përdorimit**.

Posedojnë edhe **pajisjet për shpëtim** dhe **punë në ujë** të cilat janë të nevojshme gjatë reagimit për shpëtim në ujëra.



⁵⁵ Udhëzim administrativ Nr. 39/2012-MPB për përcaktimin e kriterëve për aftësitë psiko-fizike të zjarrfikësve, neni 4, ref: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9756>

⁵⁶ Udhëzim administrativ (MPB) nr. 08/2019 për përcaktimin e pajisjeve mbrojtëse, teknike dhe mjeteve për zjarrfikje dhe shpëtim, ref: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=21027>

Në komunën e Gjakovës aktualisht janë 13 automjete për reagim emergjent të cilat kryesisht janë donacion. Shumica e automjeteve janë dhënë donacion para vitit 1999. Ka edhe pajisje të cilat nuk janë funksionale për shkak të vjetërsisë së tyre. Sa i përket pajisjeve për reagim ndaj vërshimeve janë funksionale dy barka dhe veshjet për zhytje si donacion.




Foto 4. NJPZSH në Gjakovë

Automjetet për zjarrfikje që janë në gjendje të rregullt teknike, bazuar ne UA te MPB-se Nr. 08/2019⁵⁷ specifikohet se afati i përdorimit në gjendje të rregullt i këtyre automjeteve të jetë deri 15 vite, nga viti i prodhimit. Ky UA nuk kishte rregulluar specifika tjera lidhur me afatin e përdorimit, duke mos specifikuar periudhën e fillimit të përdorimit pas datës se prodhimit, mirëmbajtjen teknike për t'ia zgjatur jetën e përdorimit dhe afatin e përdorimit të përcaktuar sipas udhëzimeve të prodhuesit. Bazuar në këtë udhëzim, të gjitha pajisjet e komunës së Gjakovës e kanë kaluar afatin e tyre të përdorimit edhe pse ato të gjitha me përjashtim të njërës janë në përdorim dhe funksionale.

Për shkak të buxhetit të vogël që ka DMSH-ja në komunën e Gjakovës është detyruar që të plotësojnë kapacitetet teknike me donacione të jashtme dhe të brendshme. Mjetet dhe pajisjet për zhytje tashmë janë të skaduara. Në 2-3 vitet e fundit kanë ndarë një sasi të mjeteve financiare për blerje të reja (për shkak të amortizimit dhe largimit të tyre nga përdorimi), ku në vitin 2020 kanë blerë mjete dhe pajisje në vlerë prej 20,000.00€.

Në komunën e Vushtrisë aktualisht janë vetëm 9 vetura që përdoren për reagim emergjent. Nga këto, 5 automjete për reagim emergjent janë marrë donacion nga Tiroli (Austria) në nëntor të vitit 2010. Automjetet dhe pajisjet e nevojshme për reagim emergjent janë të limituara. Sa i përket reagimit për vërshime nuk ka barka dhe veshje për zhytje. Për shkak të buxhetit të

⁵⁷ Udhëzim administrativ (MPB) nr. 08/2019 për përcaktimin e pajisjeve mbrojtëse, teknike dhe mjeteve për zjarrfikje dhe shptim, ref: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=21027>

vogël që ka DMSH-ja në këtë komunë është detyruar që të plotësojnë kapacitetet teknike me donacione të jashtme dhe të brendshme.

Automjetet dhe pajisjet e nevojshme për reagim emergjent janë të limituara për të përmbushur nevojat e zjarrfikësve sepse jo të gjitha janë në gjendje të rregullt për përdorim. Këto automjete mund të shkaktojnë vonesë në reagim të situatave emergjente nëse nuk janë në gjendje të rregullt teknike gjatë shfrytëzimit.

4. Konkluzionet

Institucionet përgjegjëse në nivelin qendror dhe atë lokal, nuk kanë arritur të krijojnë një sistem të përshtatshëm i cili siguron në mënyrë efektive parandalimin dhe reagimin ndaj situatave emergjente të vërshimeve/përmbytjet në Republikën e Kosovës.

Mospërditësimi i Planeve kyçe nga KSK-ja, AME-ja dhe komunat për menaxhimin e situatave emergjente kombëtare dhe lokale, mungesa e burimeve njerëzore dhe materialeve reaguese, mungesa e planit të komunikimit të përbashkët, paqartësitë në ndarjen e përgjegjësisë të koordinimit, janë disa nga mangësitë të cilat vështirësojnë aktivitetet që ndërmerren në aspektin e parandalimit dhe reagimit në sistemin ekzistues të menaxhimit të emergjencave për rastet e vërshimeve.

Strategjia e Sigurisë e Republikës së Kosovës dhe Plani i Reagimit Kombëtar vazhdojnë të përdoren si dokumente që nga viti 2010, duke mos ju përshtatur nevojave të fundit në menaxhimin e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera. Institucionet reaguese dhe koordinuese nuk kanë një plan të qartë komunikimit gjatë menaxhimit të emergjencave duke e zgjatur zingjirin e komunikimit në mënyrë të panevojshme. Gjithashtu, nuk ka sistem të përbashkët të komunikimit për të gjitha palët reaguese në incident gjë që pamundëson komunikimin në distancë mes njësive duke e vështirësuar procesin e reagimit. Në dy komunat e përzgjedhura si raste studimi në këtë auditim, gjatë ndërhyrjeve të përbashkëta, nuk ka pasur përcaktim të qartë të Komandës së Incidentit apo transferim formal të Komandës si dhe nuk ka pasur të caktuar Komandë të Përbashkët për njësitë reaguese. Kjo ka ardhur si rezultat i mungesës së një plani të qartë që jep udhëzimet e nevojshme se si të bëhet përcaktimi dhe transferi i Komandës së Incidentit gjatë këtyre reagimeve.

AME-ja nuk ka përditësuar dokumentin e vlerësimit të rrezikut në nivel vendi që nga viti 2016, me ç'rast nuk i reflekton rreziqet aktuale që i kanosen vendit. Që nga viti 2019, databaza DesInventar nuk është plotësuar me të dhënat e plota e cila pasqyron rreziqet kryesore nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në Kosovë. Mungesa e këtyre të dhënave paraqet problem për vlerësime të rrezikut në të ardhmen duke mos qenë të informuar se si dhe ku kanë ndodhur këto fatkeqësi.

Në kuadër të AME-së mungon Divizioni i Inspektorit Kryesor, i cili ka për qëllim verifikimin e gjendjes së planeve dhe përgatitjeve tjera për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë dhe si pasojë këto detyra nuk ushtrohen nga askush.

AME nuk ka bërë matjen e nivelit të performancës së NJPZSH-së sipas treguesve të përcaktuar për periudhën 2019-2020. Në mungesë të matjes së performancës, devijimet e njësive në lidhje me intervenimet mund të kalojnë pa u vërejtur dhe për to mund të mos ndërmerren veprimet e nevojshme korrigjuese.

Komuna e Vushtrrisë dhe e Gjakovës nuk kanë arritur të përpilojnë raporte të vlerësimit për ndërhyrjet e bëra për rastet e vërshimeve Janar 2019 - Janar 2021, gjë që ka pamundësuar evidentimin mangësitë që e kanë përcjellë procesin si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e këtyre mangësive.

Dokumentet e vlerësimit të rrezikut dhe planet reagimit komunal vazhdojnë të përditësohen dhe përdoren pa qenë të miratuara në Kuvendin Komunal.

AME-ja nuk ka kapacitetet e mjaftueshme të personelit për të qenë gati për emergjencat. AME-ja ka arritur të funksionalizoj vetëm pjesërisht njësinë për mbrojtje dhe shpëtim nga ujërat. Nga ana tjetër, FSK-së ka njësinë për Kërkim-Shpëtim në Ujëra, e cila për momentin, është e vetmja njësi reaguese që merret edhe me pjesën e kërkim-shpëtimit në ujëra të thella (zhytje). FSK-ja ka ndërhyrë si reagues i parë për operacione të kërkim shpëtimit në ujëra gjatë muajit janar 2021 pasi AME-ja nuk ka poseduar kapacitetet e nevojshme njerëzore për të kryer aktivitetet e kërkim-shpëtimit pa asistencën e njësive të FSK-së.

NJPZSH-ja vazhdon të reagoj në situata të ndryshme emergjente edhe pse nuk ju bëhet asnjë verifikim shëndetësor, qofshin ato verifikime fizike apo psikologjike. Reagimi në emergjencë të ndryshme mund të ketë edhe pasoja psiqike mirëpo këto verifikime nuk bëhen fare.

Kapacitet teknike kanë një jetëgjatësi deri kur duhet të shfrytëzohen ato. Edhe pse reagojnë me kapacitete të mangëta dhe të vjetëruara, NJPZSH-ja ka hasur në vështirësi gjatë reagimit pikërisht për shkak të vjetërsisë së tyre. Këto automjete shpesh herë janë në riparim me ç'rast jo të gjitha janë të gatshme për shfrytëzim.

5. Rekomandimet

Me qëllim që institucionet publike të krijojnë një sistem të përshtatshëm i cili siguron në mënyrë efektive parandalimin dhe reagimin ndaj situatave emergjente me fokus vërshimet, duhet me prioritet të zbatohet rekomandimet në vijim:

Rekomandimet për Këshillin e Sigurisë së Kosovës:

1. Të përditësohet Strategjia aktuale e Sigurisë e Republikës së Kosovës me rrethanat e fundit që i përgjigjen nevojave reale të sektorit të emergjencave. Të bëhet rishikimi i Strategjisë së Sigurisë në baza të rregullta.

Rekomandimet për Ministrinë e Punëve të Brendshme/Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave:

2. Të përditësohet Plani i Reagimit Kombëtar për të qenë i zbatueshëm në menaxhimin e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera me fokus në përcaktimin e përgjegjësive të koordinimit, komunikimit dhe përcaktimit të komandantit të incidentit.
3. Të përditësohet dokumenti i vlerësimit të rrezikut në nivel vendi, në koordinim me komunat dhe institucionet përkatëse si dokument bazë për hartimin e planeve operative dhe planeve tjera.
4. Të sigurohen të dhënat e plota historike për çdo fatkeqësi natyrore apo fatkeqësi tjetër në nivel vendi në mënyrë që këto të dhëna të përdoren për matjen e rreziqeve dhe për parandalimin e fatkeqësive që mund të ndodhin në të ardhmën.
5. Të bëhet monitorimi në komuna mbi gjendjen e posedimit të dokumenteve të vlerësimit të rrezikut, planit për reagim komunal dhe matja e performancës së NJPZSH-ve.
6. Të lidhet marrëveshja midis MPB-së dhe Institutit të Mjekësisë së Punës për kontrollet dhe të kryhen ekzaminimet për të gjitha kategoritë e zjarrefikësve në baza të rregullta vjetore.

Rekomandimet për Agjencinë e Menaxhimit të Emergjencave, për drejtorinë përkatëse për mbrojtje dhe shpëtim në komunën e Gjakovës dhe të Vushtrrisë:

7. Të bëhet fuqizimi dhe ngritja e kapaciteteve njerëzore në atë nivel ku mund të menaxhohen situatat emergjente duke përfshirë edhe njësinë për kërkim-shpëtim në ujëra.
8. Të bëhet zëvendësimi i kapaciteteve teknike që janë në gjendje për reagim emergjent dhe të plotësohet numri me kapacitet në atë nivel ku mund të menaxhohen situatat emergjente.

Rekomandimet për drejtorinë përkatëse për mbrojtje dhe shpëtim në komunën e Gjakovës dhe të Vushtrrisë

9. Të rishikohen dhe të kompletohen dokumentet e vlerësimit të rrezikut dhe planet për reagim komunal sipas rrethanave aktuale si dhe të dërgohen për rishikim dhe miratim në Kuvendin Komunal.
10. Të përpilohen raporte të vlerësimit pas ndërhyrjeve që do të bëhen në të ardhmen për rastet emergjente të vërshimeve ku do të adresohen mangësitë e identifikuara si dhe të merren veprimet korrigjuese për to.

Rekomandimet për Këshillin e Sigurisë së Kosovës, Agjencinë e Menaxhimit të Emergjencave dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës

11. Të funksionalizohet sistemi i përbashkët i komunikimit për të gjitha palët reaguese në mënyrë që të mundësohet koordinimi dhe reagimi i përbashkët mes njësive të ndryshme pjesëmarrëse në intervenim gjatë emergjencave.

Shtojca 1. Kriteret, fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Kriteret e auditimit

Kriteret e auditimit të përdorura në këtë auditim rrjedhin nga legjislacioni vendor, praktikat e mira ndërkombëtare dhe direktivat relevante evropiane.

Strategjia e sigurisë duhet rishikuar rregullisht dhe të përshtatet me rrethanat e ndryshueshme.⁵⁸ Këshilli i Sigurisë së Kosovës në koordinim me Presidentin e Republikës së Kosovës, udhëheq procesin e rishikimit të Strategjisë Kombëtare të Sigurisë aktuale dhe harton një Strategji të re Kombëtare të Sigurisë për tu miratuar nga Qeveria dhe dorëzuar në Kuvend për miratim përfundimtar. Ky rishikim dhe prezantim i Strategjisë së re Kombëtare të Sigurisë për miratim duhet të bëhet jo më larg se fundi i shtatorit 2014.⁵⁹

Çdo institucion shtetëror, komunat, ndërmarrjet dhe organizatat tjera duhet⁶⁰ të hartojnë planet për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë. Këto plane hartohen për fazat e parandalimit, reagimit dhe rimëkëmbjes të cilat hartohen në bazë të dokumentit “Vlerësimi i Rrezikshmërisë” nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera. Hartimi i këtyre planeve bëhet në bashkëpunim me AME-në dhe ato duhet të rishikohen në baza të rregullta. Implementimi i Planit të Reagimit Kombëtar duhet të bëhet katër muaj pas datës së publikimit të tij. Në fund të kësaj periudhe MPB-ja do të bëjë rishikimin një vjeçar për të vlerësuar procesin e implementimit dhe për të bërë rekomandime tek ministri, për përmirësimet e domosdoshme të PRK-së. Në vijim të këtij rishikimi ky dokument do të rishikohet dhe publikohet çdo katër vjet. Ndërsa sipas rregulloreve, PRK duhet të rishikohet cdo dy vite.⁶¹

Zhvillimi dhe zbatimi i gatishmërisë së emergjencave kërkon mekanizma të fuqishëm koordinimi që përfshijnë pjesëmarrjen multisektoriale dhe partnerët. Koordinimi midis të gjithë partnerëve është thelbësor për çdo aspekt të procesit dhe u mundëson aktorëve të komunitetit, vendas, kombëtar, ndërkufitar dhe ndërkombëtar të punojnë drejt objektivave të përbashkëta nën një proces të përbashkët planifikimi. Prioritetet për forcimin e gatishmërisë për emergjencat duhet të përshkruhen qartë në planin e reagimit; përgjegjësit dhe përgjegjësitë e tyre duhet të jenë të identifikuar qartë.⁶²

Udhëheqja në nivelin e incidentit lehtëson komunikimin përmes zhvillimit dhe përdorimit të një plani të përbashkët komunikimi, proceseve të ndërveprimit të komunikimit dhe sisteme që përfshijnë lidhje me zë dhe të dhëna. Komunikimet e integruara sigurojnë dhe mbajnë

58 Strategjia e Sigurisë e Republikës së Kosovës 2010, ref: <https://bit.ly/3u8MZGk>

59 Qeveria e Republikës së Kosovës - Analizë e Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë së Republikës së Kosovës, Mars 2014, ref: <https://bit.ly/3yuIx8b>

60 Rregullore Nr. 08/2013 Për përmbajtjen dhe procedurat e hartimit të planeve të reagimit emergjent1, neni 7, ref: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10170>

61 Rregullore Nr. 08/2013 Për përmbajtjen dhe procedurat e hartimit të planeve të reagimit emergjent1, neni 28, ref: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10170>,

62 World Health Organisation 2017, A Strategic Framework for Emergency Preparedness, ref: <https://apps.who.int/iris/bitstream/handle/10665/254883/9789241511827-eng.pdf;jsessionid=2839365893FC6D4A7F6732FC42694C7F?sequence=1>

kontakte mes burimeve të incidenteve, mundësojnë lidhjen midis niveleve të ndryshme të qeverisjes, arrijnë vetëdijen e situatës dhe lehtësojnë shkëmbimin e informacionit.⁶³

Me qëllim të menaxhimit dhe zbatimit të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës dhe detyrave tjera operative brenda fushëveprimit të mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera Ministria do të krijoj një sistem autonom të komunikimit elektronik⁶⁴ Agjencia kryen detyra menaxheriale dhe teknike të mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, veçanërisht në: planifikimin, ngritjen, funksionimin dhe mirëmbajtjen e sistemit unik të komunikimit, informimit dhe përcaktimit të kushteve teknike për integrimin e sistemeve tjera⁶⁵

Komanda e Përbashkët përmirëson unitetin e përpjekjeve në menaxhimin e incidenteve multi-juridiksionale ose shumë-agjencie. Përdorimi i Komandës së Unifikuar u mundëson juridiksioneve dhe atyre me autoritet ose përgjegjësi funksionale për incidentin që së bashku të menaxhojnë dhe drejtojnë aktivitetet e incidentit përmes krijimit të një grupi të përbashkët të objektivave të incidentit, strategjive dhe një veprimeve të reagimit të unifikuara. Sidoqoftë, secili partner pjesëmarrës mban autoritetin, përgjegjësinë dhe llogaridhënien për personelin e tij dhe burimet e tjera, dhe secili anëtar i komandës së unifikuar është përgjegjës për mbajtjen e anëtarëve të tjerë të komandës së unifikuar të informuar.⁶⁶ Funksioni i komandës duhet të ngritet qartazi nga fillimi i operacioneve të incidentit. Agjencia me autoritetin parësor për incidentin, cakton personin përgjegjës për ngritjen e komandës në vendngjarje. Me rastin e transferit të komandës, procesi duhet të përfshijë brifingun (udhëzimet -të gjitha informacionet esenciale) për vazhdimin e operacioneve të sigurta dhe efektive.⁶⁷ Komanda e Përbashkët duhet të përcaktojë qartë funksionin e komandës në fillim të një incidenti. Kur komandat transferohet, procesi i transferimit përfshin një përmbledhje që kap informacionin thelbësor për vazhdimin e operacioneve të sigurta dhe efektive, dhe njoftimin e të gjithë personelit të përfshirë në incident.⁶⁸ Në incidentet që përfshijnë juridiksione të shumëfishta, komanda e bashkuar iu mundëson agjencive me nivel të ndryshëm të autoritetit dhe përgjegjësisë ligjore, gjeografike apo funksionale, të punojnë së bashku në mënyrë më efektive, pa prekur autoritetin, përgjegjësinë apo përgjegjshmërinë individuale të agjencive.⁶⁹

Vlerësimi i rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera identifikon kërcënimet nga rreziqet në Republikën e Kosovës, si dhe vlerësimin e shkallës së rrezikshmërisë së tyre. AME-ja obligohet të bëjë vlerësimin e rrezikshmërisë së popullatës, të mirave materiale, kulturore dhe mjedisit nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në nivel vendi. Bartësit

63 Federal Emergency Management Agency, National Incident Management System 2017, ref: https://www.fema.gov/sites/default/files/2020-07/fema_nims_doctrine-2017.pdf

64 Ligji për Fatkeqësitë Natyrore, Neni 53 ref: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2775>

65 Ligji për Fatkeqësitë Natyrore, Neni 94 ref: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2775>

66 Federal Emergency Management Agency, National Incident Management System 2017, ref: https://www.fema.gov/sites/default/files/2020-07/fema_nims_doctrine-2017.pdf

67 Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave 2010, ref: <https://ame.rks-gov.net/content/templates/ame/uploads/2020-10/SIME%20i%20Miratuar.pdf>

68 Federal Emergency Management Agency, National Incident Management System 2017, ref: https://www.fema.gov/sites/default/files/2020-07/fema_nims_doctrine-2017.pdf

69 Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave 2010, ref: <https://ame.rks-gov.net/content/templates/ame/uploads/2020-10/SIME%20i%20Miratuar.pdf>

tjerë të vlerësimit, në këtë rast komunat, janë të obliguar që vlerësimet e tyre t'i harmonizojnë me vlerësimin në nivel vendi.⁷⁰

Databaza DesInventar (disaster inventory system) me të dhëna historike është një mjet që ndihmon për të analizuar trendet e katastrofës dhe ndikimet e tyre në një mënyrë sistematike. Me një kuptim të shtuar të tendencave të katastrofës dhe ndikimeve të tyre, mund të planifikohen masa më të mira parandalimi, zbutjeje dhe gatishmërie për të zvogëluar ndikimin e katastrofave në komunitetet.⁷¹

Komunat duhet⁷² të hartojnë planet për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë. Këto plane hartohen për fazat e parandalimit, reagimit dhe rimëkëmbjes të cilat hartohen në bazë të dokumentit “Vlerësimi i Rrezikshmërisë” nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera. Hartimi i këtyre planeve bëhet në bashkëpunim me AME-në dhe ato duhet të rishikohen në baza të rregullta⁷³. Për rastet të cilat nuk zbatojnë këto masa parashihen ndëshkime me gjobë për shkelje të masave mbrojtëse ndaj fatkeqësive⁷⁴ sipas nivelit të shkeljes.

Matja e performancës është e nevojshme për të lejuar njësitë të përcaktojnë një nivel bazë të performancës sipas treguesve; për të vendosur qëllime të bazuara në performancën aktuale; për të përcaktuar hendekun midis qëllimeve të dëshiruara dhe niveleve aktuale të performancës; për të ndjekur progresin drejt arritjes së qëllimeve; për të krahasuar performancën ndërmjet njësite; për të identifikuar problemet dhe shkaqet eventuale; dhe, për të planifikuar për të ardhmen. Matja e njësite të zjarrfikësve sipas të njëjtëve tregues, mundëson që praktikrat e mira të zbatohen më lehtë.⁷⁵ Ministria e Punëve të Brendshme duhet të kryej mbikëqyrjen e ushtrimit të detyrave të agjencisë dhe njësite të zjarrfikjes dhe shpëtimit që veprojnë në komuna.⁷⁶

Komunat, duhet⁷⁷ të hartojnë planet për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë. Këto plane hartohen për fazat e parandalimit, reagimit dhe rimëkëmbjes të cilat hartohen në bazë të dokumentit “Vlerësimi i Rrezikshmërisë” nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera. Komunat, janë të obliguar që vlerësimet e tyre të rrezikut t'i harmonizojnë me vlerësimin e rrezikut në nivel vendi. Vlerësimin e rrezikut në nivel lokal e harton organi kompetent komunal, në formë drafti, të cilin e dërgon në AME për shqyrtim profesional dhe përmbajtësor, merr opinion nga AME-ja dhe pastaj procedohet për miratim⁷⁸ në Kuvendin Komunal.⁷⁹

70 Rregullore Nr. 28/2012 Për metodologjinë e hartimit të vlerësimit të rrezikshmërisë, neni 19, ref: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10293>

71 Sistemi DesInventar, ref: http://desinventar.cimafoundation.org/what_is.html

72 Rregullore Nr. 08/2013 Për përmbajtjen dhe procedurat e hartimit të planeve të reagimit emergjent1, neni 7, ref: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10170>

73 Rregullore Nr. 08/2013 Për përmbajtjen dhe procedurat e hartimit të planeve të reagimit emergjent1, neni 21, ref: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12509>,

74 Ligji nr. 04/-L-027 Për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera, neni 116-119, Ref: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2775>

75 National Fire Protection Association - Fire Department Operational Performance Measures, ref: <https://nfpa.org/-/media/Files/Membership/member-sections/Metro-Chiefs/Urban-Fire-Forum/2018/2018UFFPerformanceMeasures.ashx>

76 Ligji Nr. 04/-L-049 Për Zjarrfikje dhe Shpëtim, Neni 4, ref: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2778>

77 Rregullore Nr. 08/2013 Për përmbajtjen dhe procedurat e hartimit të planeve të reagimit emergjent1, neni 7, ref: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10170>

78 Ligji për vetëqeverisjen locale, neni 12, ref: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>

79 Rregullore Nr. 28/2012 Për metodologjinë e hartimit të vlerësimit të rrezikshmërisë, neni 17, ref: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10293>

AME-ja dhe institucionet e tjera duhet të sigurojnë burimet e nevojshme për menaxhimin e situatave emergjente.⁸⁰ Njësitë profesionale të zjarrfikjes dhe shpëtimit, mund të ndryshojnë raport me vlerësimin e rrezikshmërisë në aspektin e mbrojtjes nga zjarri si dhe numrit të banorëve në zonat përkatëse të përgjegjësisë. Caktimi i numrit të zjarrfikësve mund të bëhet edhe sipas numrit të banorëve dhe atë për çdo 1500 banorë duhet të ketë së paku një zjarrfikës profesional.⁸¹ Për të ushtruar veprimtarinë për zjarrfikje dhe shpëtim, zjarrfikësit duhet të posedojnë pajisje personale dhe të përbashkëta mbrojtëse, pajisje teknike dhe mjete për zjarrfikje dhe shpëtim.⁸² Nëse forcat dhe resurset në dispozicion janë të pamjaftueshme për tu përball me operacionet e domosdoshme të shpëtimit dhe ndihmës, atëherë, mund të kërkohet dislokimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe resurset e tyre për mbrojtje.⁸³ AME duhet të ketë të funksionalizuar Njësinë për intervenime të specializuara e strukturave të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës të nivelit qendror për shpëtim nga ujërat.⁸⁴

Komunat duhet të sigurojnë burimet e nevojshme për menaxhimin e situatave emergjente.⁸⁵ Njësitë profesionale të zjarrfikjes dhe shpëtimit, mund të ndryshojnë raport me vlerësimin e rrezikshmërisë në aspektin e mbrojtjes nga zjarri si dhe numrit të banorëve në zonat përkatëse të përgjegjësisë. Caktimi i numrit të zjarrfikësve mund të bëhet edhe sipas numrit të banorëve dhe atë për çdo 1500 banorë duhet të ketë së paku një zjarrfikës profesional.⁸⁶ Për të ushtruar veprimtarinë për zjarrfikje dhe shpëtim, zjarrfikësit duhet të posedojnë pajisje personale dhe të përbashkëta mbrojtëse, pajisje teknike dhe mjete për zjarrfikje dhe shpëtim.⁸⁷

NJPZSH duhet t'ju bëhet çdo vit verifikimi i aftësisë psiko fizike që nënkupton aftësinë shëndetësore, mendore dhe aftësinë fizike. Komandanti i NJPZSH është i obliguar të organizoj, mbikqyrë dhe evidentoj kryerjen e kontrolleve të rregullta shëndetësore⁸⁸. Kontrollat dhe ekzaminimet për të gjitha kategoritë e zjarrfikësve përcaktohen me marrëveshje të lidhur midis MPB-së dhe Institutit të Mjeksisë së Punës⁸⁹.

Komanda e Incidentit ndër funksionet e veta ka edhe nxjerrjen e mësimave të marra nga situata e menaxhuar përmes raporteve të vlerësimit pas incidentit. Ndërsa përpjekja për menaxhimin e incidenteve evoluon, koha shtesë e drejtimit, personeli, sistemet e informacionit

80 Plani i Reagimit Kombëtarë, fq.100, Ref: https://ame.rks-gov.net/Portals/0/Files/Plani%20Reagimit%20Kombetar_14_01_11.pdf

81 Rregullore Nr. 16/2012 për strukturën organizative të njësive profesionale të zjarrfikjes dhe shpëtimit, neni 14, ref: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8381>

82 Udhëzim administrativ (MPB) nr. 08/2019 për përcaktimin e pajisjeve mbrojtëse, teknike dhe mjeteve për zjarrfikje dhe shpëtim, ref: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=21027>

83 Ligji Nr. 04/-L-027 Për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, Neni 15, ref: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2775>

84 Rregullore (QRK) - Nr. 18/2015 Për Organizimin e Njësive të Strukturave për Mbrojtje, Shpëtim dhe Ndihmë, Shtojca Nr.2, ref: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=35697>

85 Plani i Reagimit Kombëtarë, fq.100, Ref: https://ame.rks-gov.net/Portals/0/Files/Plani%20Reagimit%20Kombetar_14_01_11.pdf

86 Rregullore Nr. 16/2012 për strukturën organizative të njësive profesionale të zjarrfikjes dhe shpëtimit, neni 14, ref: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8381>

87 Udhëzim administrativ (MPB) nr. 08/2019 për përcaktimin e pajisjeve mbrojtëse, teknike dhe mjeteve për zjarrfikje dhe shpëtim, ref: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=21027>

88 Udhëzim administrativ Nr. 39/2012-MPB për përcaktimin e kriterëve për aftësitë psiko-fizike të zjarrfikësve, neni 4, ref: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9756>

89 Udhëzim administrativ Nr. 39/2012-MPB për përcaktimin e kriterëve për aftësitë psiko-fizike të zjarrfikësve, neni 4, ref: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9756>

dhe teknologjitë mundësojnë planifikim dhe katalogim më të hollësishëm të ngjarjeve dhe mësimave të marra.⁹⁰

Fushëveprimi i auditimit

Institucionet e nivelit lokal janë përgjegjëse për të menaxhuar rastet e përmytjeve që ndodhin në territorin e tyre. Për rastet që nuk mund të menaxhohen vetëm nga niveli lokal, kërkohet mbështetja e institucioneve të nivelit qendror. Pjesë e auditimit nga niveli qendror do të jenë: Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave (AME) në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), Qendra e Situatave (QS) në kuadër të Këshillit të Sigurisë së Kosovës dhe Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK). Nga niveli lokal pjesë e auditimit do të jenë komuna e Gjakovës dhe ajo e Vushtrrisë.

Auditimi do të përfshijë periudhën 2019, 2020 deri në janar 2021, duke përfshirë edhe aktivitetet e mëhershme të cilat lidhen me periudhën në fokus të auditimit. Përcaktimi i kësaj periudhe është bërë me qëllim të përfshirjes në auditim të informacioneve të fundit, ndërsa për çështje të krahasueshmërisë së aktiviteteve do të merren edhe vitet e mëhershme.

Në fokus të auditimit do të jenë aktivitetet e zhvilluara nga AME-ja, MPB-ja, QS-ja, FSK-ja dhe komunat e përzgjedhura, për parandalimin dhe reagimin ndaj rasteve emergjente të përmytjeve. Në këtë auditim nuk do të përfshihet faza e rimëkëmbjes nga situatat emergjente pasi ajo mund të konsiderohet në një auditim të veçantë.

Gjatë auditimit në bazë të rezultateve do të shqyrtohen edhe raste të menaxhimit të emergjencave në dy komuna, Gjakovë dhe Vushtri. Komunat janë përzgjedhur duke marrë parasysh shpeshtësinë e fatkeqësive të ndodhura për periudhën e fushëveprimit të këtij auditimi.

Metodologjia e auditimit

Për këtë auditim do të përdoren dëshmitë fizike, verbale, të dokumentuara dhe analitike, gjithmonë duke u siguruar se këto dëshmi janë relevante, të besueshme dhe të mjaftueshme. Metodatat e përdorura në këtë auditim përfshijnë:

- *Analizimi i kornizës së nevojshme ligjore dhe institucionale për adresimin e çështjeve të menaxhimit të emergjencave;*
- *Identifikimi dhe analizimi praktikave të mira me qëllim të përcaktimit të kritereve të auditimit;⁹¹*
- *Mbajtja e intervistave me zyrtarët përgjegjës brenda institucioneve të përzgjedhura në lidhje me sistemin e menaxhimit të emergjencave;*
- *Analizimi i Planit të Reagimit Kombëtar;*
- *Analizimi i Planeve të Reagimit të institucioneve të përzgjedhura;*

⁹⁰ Federal Emergency Management Agency, National Incident Management System 2017, ref: https://www.fema.gov/sites/default/files/2020-07/fema_nims_doctrine-2017.pdf

⁹¹ Good emergency management practices: The essentials - Nick Honhold, Ian Douglas, William Geering, Arnon Shimshoni, Juan Lubroth, Rome 2011

- *Rishikimi i procesit të menaxhimit të emergjencave;*
- *Ekzaminimi i dokumenteve mbështetëse të aktiviteteve të ndërmarra për menaxhimin e emergjencave në nivel qendror dhe atë lokal;*
- *Analizimi i dokumenteve raportuese dhe atyre të monitorimit të aktiviteteve për menaxhim të emergjencave;*
- *Ekzaminimi i korrespondencave ndërmjet palëve relevante në çështjet që lidhen me menaxhimin e emergjencave;*
- *Ekzaminimi i programeve të trajnimit dhe aktiviteteve të zhvilluara për këtë qëllim;*
- *Analizimi i raporteve dhe dokumenteve relevante tjera që ndërlidhen me aktivitetet e zhvilluara për menaxhim të emergjencave;*
- *Analizimi dhe vlerësimi i pyetësorit të dërguar komunave dhe përzgjedhja e dy komunave duke u mbështetur në pëgjigjet e marra; dhe*
- *Vëzhgimi në terren në dy komunat që janë përballur me vërshimet e fundit.*

Shtojca 2. Përshkrimi i sistemit dhe akterëve relevant

Cikli i menaxhimit të emergjencave ilustron procesin e vazhdueshëm sipas të cilit institucionet planifikojnë dhe zvogëlojnë ndikimin e emergjencave (hapi i parandalimit), reagojnë gjatë dhe menjëherë pas një emergjence të ndodhur si dhe ndërmarrin masa për tu rimëkëmbur pas një emergjence të ndodhur. Në vijim do të përshkruhen pjesëmarrësit si dhe përgjegjësitë e tyre në këtë cikël.

Përgjegjësitë e nivelit qendror

Niveli qendror është përgjegjës për zbatimin e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në rastet kur komunat nuk mund të kryejnë të vetme menaxhimin e emergjencave në territorin e tyre. Përgjegjësitë e këtij niveli përfshijnë: menaxhimin e sistemit të mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, aktivitetet e zhvillimit të kërkimeve dhe për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, përpunimin e vlerësimit të rreziqeve dhe planeve shtetërore të reagimit emergjent, si dhe aktivitete të tjera që ndërlidhen me menaxhimin e situatave emergjente.⁹²

Qendra e Situatave funksionon në kuadër të Këshillit të Sigurimit të Kosovës. Kjo qendër ka rol informues dhe koordinues për aktivitetet operacionale për menaxhimin e krizave në tërë Kosovën. Të gjitha ministritë relevante, institucionet e sigurisë dhe agjencitë duhet t'i ofrojnë informata Qendrës në lidhje me krizat. Qendra po ashtu mbështetet nga përfaqësuesit e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe agjencitë tjera.⁹³

Ministria e Punëve të Brendshme ka themeluar Agjencinë si organ të pavarur në kuadër të saj e cila vepron nën autoritetin e drejtpërdrejtë të ministrit të MPB-së dhe kryen veprimtari për ndërtimin, ruajtjen, ngritjen dhe avancimin e sigurisë së përgjithshme në fushën e menaxhimit emergjent, dhe ofrimin e shërbimeve profesionale.

Agjencia e Menaxhimit Emergjent (AME) është agjenci ekzekutive e themeluar me ligj në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Agjencia organizohet në nivel qendror dhe lokal. Drejtoria e Përgjithshme e Agjencisë, është niveli qendror përgjegjës për tërë Republikën e Kosovës. Agjencia kryen detyra menaxheriale dhe teknike të mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera (fatkeqësitë që ndodhin nga faktori njeri psh aksidentet industriale, shpërthimi i sëmundjeve të reja kërcënuese dhe sëmundjet e përhapura ngjitëse).⁹⁴ AME i përgjigjet drejtpërsëdrejti Ministrit.⁹⁵

AME⁹⁶ ndër të tjera jep propozime për projekte zhvillimore dhe kërkimore dhe për programin dhe planin kombëtar, kujdeset për organizimin dhe funksionimin e sistemit të monitorimit, lajmërimit dhe alarmimit, bënë vlerësimin e rreziqeve dhe dokumenteve teknike për planifikimin e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës. Gjithashtu AME bënë drejtimin dhe koordinimin e masave për parandalim dhe lehtësimin e pasojave, kryen monitorimin dhe lajmërimin e rrezikut dhe dhënien e udhëzimeve për përballje me to si dhe bënë hartimin e

⁹² Ligji Nr. 04/-L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera

⁹³ Ligji Nr. 03/-L-050 për Themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës

⁹⁴ Ligji Nr. 04/-L-230 për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent

⁹⁵ Ligji Nr. 04/-L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera

⁹⁶ Ligji Nr. 04/-L-230 për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent

draft planeve kombëtare të reagimit emergjent në bashkëpunim me ministritë dhe agjencitë qeveritare.

Qendrat Operative Emergjente⁹⁷ - Me qëllim të kryerjes së detyrave operative dhe të komunikimit lidhur me monitorimin, njoftimin dhe paralajmërimin në kuadër të Agjencisë, Ministria themelon qendrat operative emergjente. Në këto qendra përfshihen:

- qendra Operative e Agjencisë;
- qendrat Operative Emergjente Regjionale dhe;
- qendrat Operative Emergjente Lokale.

Qendrat operative emergjente lokale⁹⁸ mirëmbahen nga Kuvendet Komunale dhe janë aktive dhe operative vetëm në rastet fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësitve tjera apo në gjendje të jashtëzakonshme.

Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK)⁹⁹ mbron sovranitetin dhe integritetin territorial, qytetarët, pronën dhe interesat e Republikës së Kosovës. Forca e Sigurisë së Kosovës është forcë ushtarake multietnike, profesionale, e armatosur dhe e autorizuar për të shërbyer në vend dhe jashtë vendit, në pajtim me kompetencat e dhëna kushtetuese dhe ligjore.

Detyrat e përgjithshme të FSK-së janë:

1. Mbrojtja e sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës;
2. Mbështetja ushtarake autoriteteve civile;
3. Pjesëmarrja në operacionet ndërkombëtare.

Përgjegjësitë e nivelit lokal¹⁰⁰

Niveli lokal është përgjegjës për zbatimin e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e tyre. Përgjegjësitë e këtij niveli përfshijnë: menaxhimin e sistemit të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës në nivelin lokal, monitorimin e rreziqeve, paralajmërimin dhe alarmimin e popullatës, planifikimin dhe zbatimin e masave mbrojtëse, organizimin dhe pajisjen e njësive dhe shërbimeve komunale. Komunat gjithashtu duhet të kryejnë sigurimin e resurseve të domosdoshme, përpunimin dhe zbatimin e programeve trajnuese lokale si dhe restaurimin dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

Komunat bashkëpunojnë midis tyre në kryerjen e detyrave të lidhura me mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera dhe mund t'i bashkojnë resurset e tyre dhe të krijojnë resurse të përbashkëta për tu marrë me çështjet e përbashkëta në këtë fushë.

⁹⁷ Ligji Nr. 04/-L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera

⁹⁸ Ligji Nr. 04/-L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera

⁹⁹ <https://mod.rks-gov.net/?page=1,7#.YBz32-hKhPY>

¹⁰⁰ Ligji Nr. 04/-L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera

Në grafikun më poshtë janë paraqitur pjesëmarrësit në sistemin e menaxhimit të emergjencave si dhe një përshkrim i shkurtër i përgjegjësisë të tyre.

Nivelet e reagimit¹⁰¹ emergjent për rastet e vërshimeve:

Niveli I - Kur në një fatkeqësi natyrore apo fatkeqësi tjetër kërkohet mbrojtja, shpëtimi dhe ndihma, nivelet lokale (komunat) fillimisht do t'i dislokojnë njësitë dhe resurset e tyre vetanake.

- **Njësitë Profesionale të Zjarrfikjes**¹⁰² – njësi profesionale operative që marrin pjesë në intervenimet për zjarrfikjen dhe shpëtimin e njerëzve dhe pasurisë, në situata emergjente.
- **Drejtoritë Komunale** përgjegjëse për menaxhim të rasteve emergjente – bëjnë koordinimin lokal si mbështetës të NJPZSH gjatë intervenimit me resurset e nevojshme.

Si reagues të parë janë edhe **Policia e Kosovës** që bënë sigurimin e perimetrit ku ndodh intervenimi si dhe **Shërbimet Emergjente Mjekësore** që ofrojnë ndihmën mjekësore në rast nevojë.

Niveli II - Kur shkalla e fatkeqësisë apo rrezikut tejkalon kapacitetet e njësive të shërbimeve emergjente dhe resurseve aktuale të nivelit lokal apo kur ato nuk mund të sigurohen nga niveli lokal fqinjë, ato i siguron shteti nga regjionet tjera.

Agjencia e Menaxhimit Emergjent¹⁰³ - kryen detyra menaxheriale dhe teknike të mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

Niveli III - Nëse forcat dhe resurset në dispozicion janë të pamjaftueshme për tu ballafaquar me operacionet e domosdoshme të shpëtimit dhe ndihmës, atëherë, mund të kërkohet dislokimi i FSK-së dhe resurset e tyre për mbrojtje përmes QS-së.

- **Qendra e Situatave** – Funksionon në kuadër të Këshillit të Sigurisë së Kosovës. Ofron informata të shpejta rreth gjendjes dhe koordinon aktivitetet operacionale në tërë Kosovën. Shërben si qendër operacionale për mbledhjen e informatave, analizave themelore dhe mbështetjes për menaxhim të krizave¹⁰⁴. Është përgjegjësi e kësaj qendre të kërkoj mbështetje nga FSK-ja gjatë menaxhimit të rasteve emergjente.
- **Forca e Sigurisë së Kosovës** - mbron sovranitetin dhe integritetin territorial, qytetarët, pronën dhe interesat e Republikës së Kosovës.¹⁰⁵ Intervenon në situatat emergjente vetëm atëherë kur kapacitetet ekzistuese nuk mund ta menaxhojnë situatën e emergjente të vetme.


101 Ligji 04/-L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera, Neni 15

102 Ligji Nr. 04/-L-049 Për Zjarrfikje dhe Shpëtim, Neni 3

103 Ligji Nr. 04/L-230 Për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent, Neni 15

104 Ligji Nr. 03/L-050 Për Themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës, Neni 17

105 Ligji Nr. 06/L-123 Për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Neni 4

Fig 3. Sistemi i menaxhimit të emergjencave¹⁰⁶

106 Save the Children, Raporti Hulumtues i ZRRF-së për Legjislacionin dhe Përgjegjësitë e Palëve të Interesit në Kosovë, Nëntorë 2018

Shtojca 3: Letër Konfirmimet



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Këshilli i Sigurisë i Kosovës
Savet Bezbednosti Kosova / Kosovo Security Council
Sekretariati / Sekretariat / Secretariat



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të performancës “Parandalimi dhe reagimi ndaj situatave emergjente: Vërshimet”, dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Vendi dhe data: Prishtinë, 06/07/2021

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit “Parandalimi dhe reagimi ndaj situatave emergjente: Vërshimet”, (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Shpen Trdevaj


Sekretar i Përgjithshëm i KSK



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO KESHILLI I SIGURISE I KOSOVES SAVET BEZBEDNOSTI KOSOVA - KOSOVO SECURITY COUNCIL ARKIVA - ARCHIVE DALËSE	
Njesia Org. Org. Jedinice Org. Unit Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	Nr. Prot: Broj Prot: Prot. No: Data: Datum: Date:
SKSK 2	121 07.07.2021
PRISHTINE • PRISTINA • PRISTINA	



Republika e Kosovës - Republic of Kosovo
Komuna e Gjakovës - Municipality of Gjakova



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të performancës “Parandalimi dhe reagimi ndaj situatave emergjente: Vërshimet”, dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Vendi dhe data: Gjakovë 02/07/2021

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit “Parandalimi dhe reagimi ndaj situatave emergjente: Vërshimet”, (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Kryetari





318/21

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRIN	
Nr. / Br.	32136/21
Nr. i fq. / Br. st.	-1-
Data: / Datum:	07.07.2021
VUSHTRRI - VUČITRIN	

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të performancës “Parandalimi dhe reagimi ndaj situatave emergjente: Vërshimet”, dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Vushtri, më datë: 07.07.2021

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit “Parandalimi dhe reagimi ndaj situatave emergjente: Vërshimet”, (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.



Enis Maxhuni

Drejtor i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE PRANOR: 06/07/2021			
DATE PRANOR:	DATE PRANOR:	DATE PRANOR:	DATE PRANOR:
DATE PRANOR:	DATE PRANOR:	DATE PRANOR:	DATE PRANOR:
Nr. Prot.:	Nr. Prot.:	Nr. Prot.:	Nr. Prot.:
03	44	1126	1



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mbrojtjes
Ministarstvo Odbrane / Ministry of Defense

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MBROJTJES - MINISTARSTVO ODRBANE - MINISTRY OF DEFENSE	
Nr. Prot.:	Nr. Prot.:
1480	1
Br. Prot.:	Br. Prot.:
08/07/2021	1
Prishtinë / a	

Ref: 138/11/2021

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të performancës “Parandalimi dhe reagimi ndaj situatave emergjente: Vërshimet”, dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Vendi dhe data: Prishtinë, 06 Korrik 2021

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit “Parandalimi dhe reagimi ndaj situatave emergjente: Vërshimet”, (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Me respekt!

Armend MEHAJ
Ministër i Ministrisë së Mbrojtjes






Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government



Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo
Ministry of Internal Affairs

Agjencia e Menaxhimit Emergjent/Agencija Emergentnog
Management Agency.



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të performancës “Parandalimi dhe reagimi ndaj situatave emergjente: Vërshimet”, dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit Vendi dhe data: Hajvali-Prishtinë 15/07/2020

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit “Parandalimi dhe reagimi ndaj situatave emergjente: Vërshimet”, (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Fadil Kodra

Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë

